



1999

2000

2001

2002

**2003**

2004

2005

2006

2007

2008

2009

2010

## **RAPORTI VJETOR**

Mars 2004

## **Raporti vjetor 2003**

Ekziston versioni në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe  
– ju lutemi kontaktoni:

**Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës**

**Zyra për marrëdhënie me publikun**

**Garibaldi 33**

**Prishtinë, Kosovë**

**Tel: ++381 38 222 055**

**Fax: ++381 38 243 763**

**Ose vizitoni: [www.bpk-kos.org](http://www.bpk-kos.org)**

BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO  
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVËS  
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

# **RAPORTI VJETOR 2003**

Prishtinë 2004

# PËRMBAJTJA

Letër nga Shefi ekzekutiv i BPK-së dhe Drejtori menagjues  
Këshilli udhëheqës i BPK-së  
Komisioni ekzekutiv i BPK-së  
Përmbledhje ekzekutive

<b>I. Mjedisi ekonomik ndërkombëtar -----</b>	<b>10</b>
1. Ekonomia botërore -----	10
2. Bashkimi Evropian -----	11
3. Ballkani perëndimor -----	12
4. Ekonomia kosovare-----	14
4.1. Bruto Produkti Vendor -----	14
4.2. Paraja dhe Çmimet-----	15
4.3. Ndërmjetësimi financiar -----	18
4.4. Tregtia e jashtme dhe Bilanci i pagesave-----	20
4.5. Politika fiskale-----	24
<b>II. Aktivitetet e BPK-së -----</b>	<b>28</b>
Hyrje-----	28
1. Operacionet bankare -----	30
2. BPK – Autoriteti Financiar i Kosovës -----	37
Hyrje-----	37
2.1. Aktiviteti i rregullimit të sektorit financiar të BPK-së -----	37
2.2. Aktivitetet mbikqyrëse dhe detyruese-----	38
2.2.1. Licencimi dhe struktura -----	38
2.2.2. Kontrolli financiar-----	40
2.2.3. Kompetencat zyrtare të Mbikqyrësve (Veprimet detyruese)-----	41
2.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar -----	42
2.4. Zhvillimet kryesore të Sektorit financiar -----	42
<b>III. Theksimi i aktiviteteve të brendshme të BPK-së-----</b>	<b>44</b>
Zhvillimi i Burimeve Njerëzore-----	44
Politika trajnuese e BPK-së-----	44
Zbatimi i aplikacionit Flexcube-----	45
Faqja e internetit dhe buletini informativ i BPK-së -----	46
<b>IV. Raportet financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës --</b>	<b>48</b>
<b>V. Shtojcat-----</b>	<b>70</b>
Fjalori i terminologjisë-----	70
Shtojca Statistikore -----	71
Lista e tabelave -----	71
Lista e grafikëve-----	72



**BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO  
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS  
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA**

## Letër nga Shefi Ekzekutiv i BPK-së dhe Drejtori Menagjues

I nderuari Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara

Gjatë katër viteve të fundit, Kosova ka arritur një përparim të dukshëm të cilin shumë vende në zhvillim mund ta kenë zili, pasi që është dashur të ballafaqohet me sfida të dyfishtë, në njërën anë duke e drejtuar procesin e tranzicionit drejt një tregu dhe ekonomie moderne dhe në anën tjetër të rimëkëmbë çrregullimet e shkaktuara nga lufta.

Një përmbushje e tillë është arritur me anë të mobilizimit ndërkombëtar, i cili ka sjellë paqe dhe stabilitet si dhe ndihmë teknike dhe financiare. Përpjekjet e njerëzve të Kosovës, sidomos dinamizmi i gjeneratës së re, ka qenë një faktor vendimtar në këtë sukses.

Rruga është ende e gjatë, për t'i tejkaluar pengesat drejt arritjes së një ekonomie moderne dhe efikase e cila do të sigurojë vende të reja pune dhe prosperitet. Sa i përket sektorit financiar, pengesat kryesore nuk janë të natyrës teknike apo financiare, por shumica e tyre janë si rezultat i statusit të tanishëm politik të Kosovës si dhe të shprehive të mëparshme menaxhuese. Statusi i tanishëm i Kosovës vazhdon të pengoj zhvillimin ekonomik dhe financiar për shkak të dyshimeve të cilat ndikojnë në ngurrimin e investitorëve të huaj dhe vështirësitë për integrimin e Kosovës në rrjetin dhe forumet ndërkombëtare. Për shembull, si rezultat i mospjesëmarrjes së saj në sistemet e transfereve dhe pagesave ndërkombëtare si dhe në sistemin e sigurimit të Kartonit të Gjellbër, Kosova po ndikohet nga dëmet e marginalizimit.

Pavarësisht nga problemet gjatë periudhës tranzitore, Sektori Financiar, i cili është themeluar në baza të shëndosha, me rregulla që janë në harmoni me standardet dhe praktikat më të larta ndërkombëtare, dhe të mbikëqyrura nga afër, ka vazhduar të forcohet. Deri në një masë, institucionet financiare janë mbrojtur nga situata politike prej një konkurrence serioze ndërkombëtare, dhe këtë e kanë shfrytëzuar si një përparsi që në ndërkohë të forcojnë edhe më shumë pozitën e tyre gjatë fazës fillestare. Tani ka ardhur koha kur ndërtimi i strategjive të reja, zhvillimi i produkteve të reja si dhe kontrollimi i shpenzimeve administrative, kërkojnë shkathtësi më të mëdha menagjeriale, posaqërisht nëse normalizimi i situatës së tanishme do të sillte sukses në ardhjen e konkurentëve të fortë ndërkombëtarë.

Institucionet financiare, tani më kanë bërë hapat e parë për t'u ballafaquar me sfidat e reja. Bankat komerciale janë duke i zgjeruar rrjetin e tyre të korrespondimit me jashtë dhe duke krijuar partneritete për trajnimin e kuadrit të tyre. Disa institucione financiare, madje janë duke iu ofruar kuota të rëndësishme të kapitalit të tyre, institucioneve dhe investitorëve të huaj. Ky trend duhet të nxitet, për të vazhduar kështu.

Përderisa ekonomia e Kosovës, kryesisht është menagjuar me para të gatshme, metodat e reja të pagesave kanë filluar që disa muaj pas aplikimit të Bankomatëve. Me ndihmën teknike të FMN-së, BPK-ja në mënyrë aktive po e mbështetë reduktimin e përdorimit të parave të gatshme në Kosovë. Reduktimi i përdorimit të parave të gatshme së bashku me llogaritjen e përgjegjshme dhe standardet e auditimit janë kushtet vendimtare për zhvillimin e aktiviteteve të shëndosha financiare dhe një parandalim efikas kundër pastrimit të parave.

Poashtu duhet theksuar edhe zhvillimi i industrisë së sigurimeve. Kjo mund të demonstrohet me bashkëpunimin efektiv të kompanive vendore me ato që vijnë nga Shqipëria dhe Serbia, i cili bashkëpunim ka rezultuar në vendosjen e platformës së përbashkët të Teknologjisë Informative dhe seancave të përbashkëta trajnuese. Në anën tjetër, projektet e reja në sigurimin e jetës dhe aktivitetet e risigurimit, ilustrojnë përpjekjet që janë ndërmarrë, për t'i dhënë fund periudhës së monoprodukteve të sigurimeve të automjeteve-TPL, gjatë së cilës janë hasur disa shembuj të garës ekstreme dhe të papranueshme.

Gjatë kësaj periudhe, BPK-ja ka qenë e përcaktuar në rregullimin e rregulloreve për zhvillimet e reja, të përforcoj ato me një korrektësi të duhur dhe të inicoj hapat e ardhshëm drejt modernizimit. BPK-ja ka kontribuar në rritjen e lirisë së lëvizjes në kalimet kufitare, duke nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit (MEM), me organizatat dhe mbikqyrësit e sigurimit të disa shteteve fqinje. BPK-ja poashtu, ka përbushur kërkesat e institucioneve financiare, të cilat kanë kërkuar një operator të shkathtë, neutral dhe të përgjegjshëm që do të udhëhiqte shërbimet me interes të përgjithshëm siç janë pagesat ndërbankare dhe raportimi i informatave kreditore. Një hap i rëndësishëm është bërë edhe në fushën e Kërkimeve dhe Statistikës, në mënyrë që vendimmarrësit në Kosovë të furnizohen me të dhëna dhe pasqyra financiare, mungesa e të cilëve është vërejtur shumë deri më tani. Do të doja të theksoj poashtu, që BPK-ja ka mirëmbajtur paratë e besuara, në mënyrë që të furnizoj Kosovën me monedha dhe kartëmonedha në Euro, me sasi dhe cilësi të duhur, dhe kjo paraqet një arritje, pasi që BPK-ja nuk posedon kompetencën për emetimin e parave.

Duke kryer detyrat e saj të zakonshme si një Bankë Qendrore dhe një Autoritet i Shërbimeve Financiare në kuptimin e plotë të fjalës, BPK-ja ka vazhduar të përshtatë organizimin e brendshëm të saj dhe të trajnoj personelin e vet. Pas kalimit të përgjegjësisë të departamentit menagjues, në kompetencat e ekzekutesve vendorë, në Qershor të vitit 2003, tri pozita të larta menagjieriale, janë strukturuar në fillim të vitit 2004. Zyrtarët vendorë të caktuar në këto pozita, do të trajnohen në mënyrë që të marrin detyrat dhe përgjegjësitë nga zyrtarët ndërkombëtarë, në kohën e duhur, dhe të dizajnojnë organizimin, në bazë të parimeve më të mira për një qeverisje të përbashkët.

Këto të arritura ngjallin një krenari të merituar tek kuadri i BPK-së dhe menagjerët dhe ekspertët ndërkombëtarë të cilët kanë qenë pjesëmarrës në arritjen e këtyre sukseseve. Duhet cekur përkushtimi i veçantë dhe vullneti i të gjithë individëve për t'i realizuar detyrat e tyre si dhe këshillat e urta dhe ndihma teknike që na është ofruar nga FMN, BE, USAID, Banka Botërore, pa të cilat BPK-ja nuk do të arrinte këtë nivel të kapacitetit. BPK-ja gjithashtu, është përkrahur edhe nga UNMIK-u dhe IPVQ-të (Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes).

Kjo fazë e zhvillimit dhe sukseseve nuk është arritje e qëllimit, por vetëm një hap i ndërmjetëm. BPK-ja tani do të demonstroj se është një institucion i përgjegjshëm dhe i dobishëm, i gatshëm për të ballafaquar sfidën, së bashku me UNMIK-un dhe IPVQ-të, drejt zhvillimit të një sektori efikas financiar për ndërtimin e një ekonomie moderne të tregut. Ndërtimi i kapacitetit, qoftë kapacitetit teknik apo ai menagjierial, si dhe pavarësia efektive, janë kritere vendimtare për njohjen e brendshme dhe njohjen ndërkombëtare të BPK-së. Këto cilësi asnjëherë nuk janë arritur përfundimisht; BPK-ja duhet që për çdo ditë të demonstroj se është e gatshme të ballafaqohet me këtë sfidë.

Kam kënaqësinë, t'ua dërgoj Raportin Vjetor të BPK-së për vitin 2003.

Donat Branger  
Drejtor Menagjues

Prishtinë, Mars 2004

### Governing Board of the BPK

Më 31 Dhjetor 2003, Këshilli Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës përmbodhi anëtarët e poshtëshënuar:

- Z. Ajri Begu**, Udhëheqës i Këshillit Drejtues
- Z. Donat Branger**, Drejtor Menagjues i BPK-së
- Z. David Weatherman**, Zëvendës i Drejtorit Menagjues për Sektorin e Mbikqyrjes Financiare
- Z. Benoit Waelkens** Zëvendës i Drejtorit Menagjues për Sistemin e Pagesave
- Z. Nikolaus Graf Lambsdorff**, ZPSSP, BE – Shtylla e IV
- Z. Gazmend Luboteni**, Profesor, Fakulteti Ekonomik - Universiteti i Prishtinës
- Z. Petraq Milo**, në Rolin e Udhëheqësit të Zyrës për Çështje Fiskale – BE shtylla e IV, UNMIK

Komisioni i Revizionit të Këshillit Drejtues të BPK-së:

- Z. Gazmend Luboteni**, Profesor, Fakulteti Ekonomik - Universiteti i Prishtinës
- Z. Petraq Milo**, në Rolin e Udhëheqësit të Zyrës për Çështje Fiskale – BE shtylla e IV, UNMIK

### Executive Committee of the BPK

- Z. Donat Branger**, Drejtor Menagjues të BPK-së
- Z. David Weatherman**, Zëvendës i Drejtorit Menagjues për Sektorin e Mbikqyrjes Financiare
- Z. Hashim Rexhepi**, Zyrtar kryesor i mbikqyrjes
- Z. Benoit Waelkens** Zëvendës i Drejtorit Menagjues për Sistemin e Pagesave
- Mr. Gani Gërguri**, Zyrtar kryesor i operimeve
- Mr. Agron Dida**, Inspektor i Përgjithshëm

## Raport ekzekutiv

Ekonomia botërore vazhdoi të përjetoj një ngadalësim edhe vitin e tretë, por Ballkani Perëndimor ka përmbyllur edhe një vit të një zhvillimi të mirë ekonomik gjatë vitit 2003, me një rritje të paraparë të BPV (Bruto produkti vendor) rreth 4% (pak më e ultë se rritja në vitin 2003), dhe me inflacion nën 5%.

Rritja e BPV së ekonomisë së Kosovës, e llogaritur si 4.7% në vitin 2003, është njëra nga më të lartat në regjion dhe në Evropë, por përkundër kësaj BPV për person (e llogaritur rreth 700 Euro) është dukshëm më e vogël sesa nivelet e regjistruara në vendet tjera të pas-luftës, në regjion. Në të njëjtën kohë, shkalla e papunësisë (e vlerësuar si 50%) është më e larta në regjion. Ndihamat e huaja (si shtytje kryesore për rimëkëmbjen e ekonomisë së pasluftës në Kosovë) u zvogëluar gjatë vitit 2003, përderisa të hyrat nga diaspora kosovare kanë mbetur relativisht të pandryshueshme. Bilanci i pagesave është pothuajse i mjerueshëm. Eksporti i Kosovës mund të mbuloj më pak se një të gjashtën (1/6) e importeve të saj, si dhe deficitin me tregtinë e jashtme llogaritet për më shumë se 84% të BPV. Kështu, Kosova ka nevojë urgjente të pregaditë një strategji zhvillimore gjithëpërfshirëse, që do të transformonte ekonominë e mbështetur në ndihma, në një ekonomi me një zhvillim të qëndrueshëm.

Paraja në qarkullim, ka pësuar rënie afër 51%, gjatë vitit 2003 (bazuar në importin dhe eksportin me para të gatshme vetëm nëpërmes të sektorit bankar). Një nga shpjegimet për një rënie të tillë mund të gjendet në rritjen e depozitëve të parave dhe në bilancin negativ të bilancit të pagesave. Gjendja fiskale e Kosovës në vitin 2003 ka mbetur e qëndrueshme me gjithë bilancin suficitar për tri vite me radhë. Suficiti për vitin 2003 llogaritet të jetë rreth 75 million<sup>1</sup> euro.

Ndërmjetësimi financiar në Kosovë, e veçanërisht sektori bankar, vazhdoi zhvillimin e tij të shpejtë. Numri i bankave komerciale ka mbetur i njëjtë si në vitin e kaluar, por numri i përgjithshëm i degëve bankare u rrit në 148 njësi në vitin 2003, si dhe janë shtuar edhe shërbime dhe produkte të reja bankare. Thënë në përgjithësi, sistemi bankar është i kapitalizuar mirë, ndërsa BPK-ja ka rritur kërkesat e minimumit të kapitalit për bankat për vitin 2003, për t'i sjellur standardet e kapitalit në një nivel me direktivat e BE. Të gjitha bankat i kanë përmbushur kushtet me sukses.

Numri i operacioneve vjetore ndër-bankare pothuajse është dyfishuar gjatë vitit 2003, ndërsa raporti i operacioneve bankare ndaj mjeteve të tërësishme është rritur për tetë herë, nga 0.33 në 2.67. Depozitët kanë pasur edhe një ngritje në vitin 2003, duke u rritur 20.85% në krahasim me vitin e kaluar.<sup>2</sup> Kjo do të mund të spjegohet si një përmirësim në funksionimin e ekonomisë, dhe për këtë arsye edhe si rritje në aftësinë për kursim të korporatave jofinanciare, e njëkohësisht edhe si një rritje besimi ndaj sektorit bankar të Kosovës.

Viti 2003 karakterizohet me një ngritje të konsiderueshme në kreditë bankare për sektorin privat, në shumë prej 40.1% të mjeteve të tërësishme të bankave komerciale të Kosovës. Sidoqoftë, huatë janë kryesisht të një kohëzgjatjeje të shkurtër (deri në një vit) dhe me kamata relativisht të larta, dhe kjo është për shkak të faktit se shumica e depozitëve janë depozitë në të parë apo me afat më të shkurtër se një vit, që nuk mbështesin kreditë aftgjata për investime.

<sup>1</sup> Kjo shifër nuk është përfundimtare dhe mund të ndryshoj pas raportit final të MEF.

<sup>2</sup> Këto shifra janë paraqitur si të veçanta, në fund të (vitit), kështu që nuk paraqesin informatë komplete për ndryshimet në llogaritë depozitare gjatë viteve përkatëse.

Viti 2003 ka shënuar emërimin e kosovarëve në postet kyçe të menagjimit, si një hap i parë në procesin e kosovarizimit, të implementuar më 1 mars 2003. Në mënyrë që të arrihet përparim i mëtutjeshëm në procesin të kosovarizimit, dhe të sigurohet aplikimi i 'praktikave më të mira' në udhëheqjen e BPK-së si bankë qendrore, një skemë e re organizative është implementuar më 1 janar 2004.

Përveç aktivitetit të saj në furnizimin dhe mirëmbajtjen adekuate të monedhave, BPK-ja ka vazhduar me përpjekjet e saj për të zhvilluar depozitimin e parave në Kosovë. Katër banka komerciale, duke përfshirë këtu edhe BPK-në, kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në SPN (Sistemin e pagesave ndërbankare), nëpërmes të implementimit të ndërlidhjes së automatizuar në mes të serverëve të tyre (sistemeve llogaritare) dhe serverit të SPN-së. Poashtu, me mbështetjen e FMN-së BPK-ja tash ka filluar me implementimin e projektit të ri, në mënyrë që të zhvilloj mënyrat e reja të pagesës. Operacionet e fundit komerciale janë ekzekutuar nga BPK-ja, në tremujorin e parë të vitit 2003, dhe që nga ajo kohë, BPK-ja luan rolin e një bankieri për Qeverinë dhe për disa kompani publike që ofrojnë shërbime publike.

Për më tepër, BPK-ja ka marrë rolin udhëheqës në themelimin e Institutit për Trajnime Bankare, për t'i përmbushur nevojat bankare. Momentalisht bankat komerciale kanë kërkuar nga BPK-ja që të themeloj dhe të operoj Sistemin Informativ Kreditor të Kosovës, dhe kjo është në proces e sipër. BPK ka qenë anëtare e Këshillit të Kosovës mbi Standardet për Raportim Financiar (KBSFR), dhe po merr pjesë në ngritjen e standardeve llogaritëse të sektorit financiar.

Viti 2003, në veqanti është karakterizuar me caktimin e tri misioneve të FMN, si ndihmë teknike në Departamentin e Kërkimeve dhe Statistikës në BPK. Janë tri objektiva kryesore të këtyre misioneve: rritja e funksionit të Kërkimeve në Departamentin e Kërkimeve dhe Statistikës, përmirësimi i mëtutjeshëm i statistikave monetare dhe financiare (gjatë muaj të misionit peripatetik), dhe përpilimi i statistikave të bilancit të pagesave (dy vite të misionit në ESK dhe BPK).

Shuma e tërësishme e të ardhurave që shkojnë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, që burojnë nga veprimet që janë zbatuar në sektorin financiar, arrinë vlerën prej 174,250 EURO. Gjatë vitit 2003, MEM është nënshkruar me Shqipërinë, IRJM-në dhe Kroacinë.

Procedura e trajnimit të BPK-së është aprovuar së bashku me Politikën e re të Punësimit dhe Kodin etik.



## I. Mjedisi Ekonomik Ndërkombëtar

### 1. Ekonomia botërore

Ekonomia botërore në vitin 2003 është karakterizuar me një rritje të pabarabartë të ekonomive kryesore. Ngadalësimi i ekonomisë që filloi në vitin 2001 vazhdoi në vitin 2002, dhe ka qenë evident edhe në tremujorin e parë të vitit 2003. Rimëkëmbja e dobët e ekonomisë ishte si rrjedhojë e paqartësive që rrethonin situatën gjeo-politike, sektori i dobët i korporatave, tregjet e kapitalit në rënjë dhe çmimet e larta të naftës.

Tremujori i dytë i vitit 2003, ka qenë periudhë e rimëkëmbjes me një shtrirje më të madhe se që është pritur në SHBA, Japoni dhe ekonomitë në zhvillim në Azi. Rritja në vendet e OECD-së, nga vlerësimet e plota vjetore nga ana e OECD<sup>1</sup>, ka pasur rritje vjetore të BPV në vendet e OECD-së prej 2.0% në 2003, USA (3.1%)<sup>2</sup> ku paraqitet rritje mbi mesataren e vendeve të OSBE, përderisa BE (0.7%) dhe Japonia (0.1%)<sup>3</sup> kanë rënë dukshëm nën mesatare. Kina ka shënuar një ngritje të theksuar ekonomike, duke paraqitur 8.8% rritje në BPV gjatë vitit 2003. Konsiderohet që kjo rritje është në përputhshmëri me rritjen e eksportit të saj. Edhe pse dy tremujorët e parë në shtetet e Azisë që janë në zhvillim, paraqesin një periudhë të krizës ekonomike për shkak të SARS-it, vërehet një përmirësim i dukshëm në dy tremujorët pauses. BPV në ekonomitë në tranzicion dhe ato në zhvillim, në vitin 2003 paraqesin një rritje prej 5.0%, respektivisht 4.9%. Amerika Latine është karakterizuar me përmirësimin e politikës makroekonomike, një ndjenjë më të ngritur investuese, dhe me një rritje të fuqishme ekonomike në vitin 2003 (i vlerësuar si 2.0%). Afrika Sub-Saharike ka përjetuar një ngritje pak më të vogël se 5% të BPV në vitin 2003.

Korigjimet në tregjet e kapitalit kanë ndikuar pozitivisht në besueshmërinë globale të biznesit, investime dhe rritje, veqanërisht në tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2003.

Rritja e ekonomisë së SHBA-ve ka qenë si rezultat primar i rritjes së shpenzimeve të ekonomisë familjare dhe shpenzimeve kapitale të motivuara nga rritja e optimizmit. Deficiti i lartë dhe në rritje i llogarive rrjedhëse me botën e jashtme gjatë vitit 2003 ka shkaktuar rënien e dollarit të SHBA-ve. Kjo ka rezultuar me përmirësimin e neto eksporteve gjatë tremujorit të tretë, edhe pse deficiti aktual i llogarive edhe më tutje mbetet i lartë. Një ngritje në deficitin tregtar, veqanërisht me Kinën, ka rezultuar në aplikimin e më shumë masave mbrojtëse nga ana e SHBA-ve. Futja e këtyre masave mbrojtëse ka nxitur konteste ekonomike, kryesisht me BE-në.

Ekonomia amerikane është zgjeruar në gjysmën e dytë të vitit 2003, kryesisht nga rritja e borxhit të huaj, një pjesë të madhe e së cilit vazhdon të financohet nga Banka e Japonisë.

Mund të pritet që zvogëlimi i tatimeve të tanishme, i aprovuar nga Kongresi, ka pasur një ndikim të madh në rimëkëmbjen e ekonomisë së SHBA-ve. Për më tepër, deficiti buxhetor është një brengë e madhe që është paraqitur në rritjen e trendit gjatë tërë vitit. Kjo po ndodh gjithashtu me ekonomitë udhëheqëse të BE (Gjermaninë, Francën dhe Italinë).

Pas një periudhe të gjatë të një inflacioni të ulët dhe një politike të dollarit (të fortë), presionet e inflacionit u rishfaqën në ekonominë e SHBA-ve.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) ka shënuar 1.7%<sup>4</sup> në vitin 2003. BE ka arritur të mbaj mesataren e vetë të inflacionit prej 2%, përderisa në Japoni deflacioni i vazhdueshëm i ekonomisë ka qenë vërtetë brengosës. IÇK në Kinë ka qenë 0.9%, në vitin 2003. Vendet në zhvillim kanë pasur një IÇK prej 5.9% ndërsa ekonomitë kalimtare prej 9.7%.

Papunësia e përgjithshme globale është rritur në vitin 2003 dhe ka arritur në 185.9 milion, ose rreth 6.2% e fuqisë së përgjithshme punëtore. Ka mbetur në nivelet rekord për meshkuj dhe femra dhe u përhap edhe më shumë në mesin e të rinjëve, përkundër përmirësimit të rritjes së

<sup>1</sup>Burimi: OECD Indikatorët kryesorë ekonomik, Shkurt 2004

<sup>2</sup>Burimi: Buroja për Analiza ekonomike, Departamenti i Tregut, ripërpunuar më 27 Shkurt, 2004.

<sup>3</sup>Burimi: Banka e Japonisë, Pikëpamjet e udhëheqjes së ekonomisë, Vendim i Kabinetit më 19 Janar, 2004 – ndryshimet e %jes në çmimet aktuale.

ekonomisë pas një rënie dy-vjeçare, sipas raportit vjetor të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP). ONP parashikon që rimëkëmbja e ekonomisë në vitin 2003, që del se ka ndaluar keqësimin e situatës globale të punësimit, nëse është e qëndrueshme, do të vazhdoj si e tillë edhe gjatë vitit 2004.

Vlerat e tregtisë ndërkombëtare tregojnë për një shkallë të rënies prej 3.2% në vitin 2002 deri në 2.9% në vitin 2003. Ky mund të jetë si rezultat i rritjes së pasigurisë në ekonominë botërore. Deficiti tregtar i SHBA-ve është rritur rreth 11% gjatë dhjetorit, për të lënë gëpin tregtar të vitit 2003 në shumë prej 489.4 bilion dollarësh, 17% më shumë se në vitin 2002.

## 2. Bashkimi Evropian

Përkundër parashikimeve se euro-zona, me një ekonomi të madhe dhe relativisht të izoluar, do të jetë e qëndrueshme ndaj tronditjeve të jashtme, nuk ka qenë e mundur të mbahet një rritje e fuqishme kur mjedisi i jashtëm ishte duke u keqësuar.

Vrulli i rritjes në euro-zonë është ngadalësuar që nga fundi i vitit 2002 dhe në fillim të vitit 2003, prodhimi ka stagnuar dukshëm në aspektin vjetor. Konsumi privat dhe publik ka ndikuar pozitivisht në rritje edhe pse me ritëm të ngadalësuar, përderisa investimet kanë vazhduar të pësojnë rënie. Neto-eksporti mund të llogaritet si shkaktar që ka ndikuar në rënje ekonomike.

Pas tri vitesh të një rritjeje të vogël në euro-zonë, me një rritje reale të BPV prej 1.7% në vitin 2001, 0.9 % në 2002, dhe një rritje prej 0.5% (pas rishikimit të vlerësimit të parë prej 0.7%), një rritje e dobët pritet edhe në vitin e katërt.

Rezultatet relativisht të fuqishme të Britanisë së Madhe dallojnë shumë nga rritja zhgënjyese prej 0.5% në euro-zonë. Ngadalësimi i eksportit dhe investimeve në tremujorin e dytë të vitit 2003 ka qenë zvarritja më e madhe sa i përket rritjes, por edhe konsumi i ekonomisë familjare ka rënë poashtu. Politikat ekonomike kanë mbetur mjaft akomoduese. Gjendja fiskale ka mbetur si nxitëse për zgjerim në euro-zonë, ku për shumicën e vendeve është menduar se nuk do të mirmbajnë limitet buxhetore me margjina të mëdha për vitin 2003, për shkak të një rritjeje më të vogël se që është pritur.

Për vitin e dytë me radhë, Franca dhe Gjermania kanë thyer maksimumin e 3% të deficitit bugjetor, të vendosur nga Kriteret e Maastricht-it, dhe në bazë të vlerësimeve të fundit të Komisionit Evropian, janë gati që të thyejnë kriteret edhe në vitin 2004.

Për dallim nga viti 2002, kur është vërejtur rënia e vazhdueshme e euros, gjatë vitit 2003 euro ka shënuar ngritje të vlerës prej rreth 23 % krahasuar me dollarin amerikan. Ajo vazhdon të ketë rritje për shkak të deficitit të llogarisë rrjedhëse të SHBA-ve. Forcimi i euros mund të ndikoj negativisht në profitet e kompanive, posaqërisht tek ato kompani të cilat i ekspozohen tregut me vendet që nuk përkasin në Unionin Monetar Evropian (UME). Kështu, përmirësimi i bilancit të korporatave mund të zgjasë dhe kjo do të kishte një ndikim negativ në tregun e punës në një afat të shkurtër.

Gjatë vitit 2003 papunësia ka vazhduar të jetë e madhe (me lartësi prej 8.9%), me një zbutje sezonale të shkallës së papunësisë dhe pritet që të rritet edhe më tutje duke arritur në 9.1% gjatë vitit 2004. Bazuar në anketën e Komisionit Evropian mbi afarizmin dhe konsumin besueshmëria e ekonomive familjare dhe afaristëve është përmirësuar gradualisht.

Indeksi i harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) ka mbetur në nivelin prej 2.1 – 2.2% në tremujorin e tretë të vitit 2003. Kjo i është atribuar kryesisht çmimeve shumë të larta të ushqimit. IÇK në Bashkimin Evropian (BE 15) në dhjetor 2003 ka qenë 1.8%, më e ultë se IÇK prej 2% në nëntor, kryesisht si rezultat i një deflacioni të lartë prej mbi 20% e çmimeve të teknologjisë informative dhe pajisjeve elektronike. Kjo tregon se inflacioni në BE ka mbetur afër limitit të

përcaktuar nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Krahasuar me nëntorin e vitit 2002, inflacioni vjetor ka rënë në nëntë shtete anëtare, është rritur në një shtet dhe ka qëndruar i pandryshuar në pesë shtete të tjera. Frika nga një deflacion i mundshëm ka qenë evident në

<sup>4</sup> Burimi: Byroja për Analiza ekonomike, Departamenti i Tregut, ripërpunuar më 27 Shkurt, 2004.

Gjermani në gjysmën e parë të vitit 2003, por ka shënuar zbritje në gjysmën e dytë të vitit. Në mesin e shteteve që janë anëtarësuar në dhjetor të vitit 2003, inflacioni më i lartë është shënuar në Sllovakia (9.5%) dhe më i ulët në Lituani (-1.3%).

### 3. Ballkani Perëndimor

Regjioni i Ballkanit Perëndimor, përbëhet nga ekonomi relativisht të vogla të: Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës (BeH), Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM) dhe Kosova.

Ekonomia më e madhe, me një BPV prej më shumë se 23 miliard euro, është ajo e Kroacisë.

Viti 2003 ka qenë edhe një vit i suksesit ekonomik për Ballkanin Perëndimor, me një rritje të pritur të BPV prej rreth 4%, pak më ulët se rritja e vitit 2002. Inflacioni ka vazhduar të shënoi rënie në vitin 2003 nën 5%, për herë të parë që nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë. Në vitin 2003 mund të vërehet një përmirësim i vogël i financave publike. Bazuar në Komisionin Evropian, deficitit qeveritar për regjionin është parashikuar që do të jetë deri në 4% të BPV. Mosbarazimi në tregtinë e jashtme mbetet tejet i lartë në të gjitha vendet e regjionit me një deficit të llogarisë rrjedhëse me botën e jashtme prej 8% të BPV dhe deficit të tregtisë së jashtme prej 28% të BPV. Një përparim i mëtejshëm kërkohet për reformat e orientuara në ekonomi të tregut, në mënyrë që të arrihen standardet e BE.

Stabilizimi politik dhe proceset reformuese të cilat janë në avancim, vazhdojnë të kenë ndikim pozitiv në gjendjen ekonomike të vendeve në regjion. Vlerësimet e para të plota vjetore, paraqesin një rritje të BPV, prej vitit në vit, 4.2% në vitin 2003, që do të thotë ka pësuar një rënie të vogël në krahasim me 4.5% gjatë vitit 2002.

**Tabela 1. Ballkani Perëndimor – Indikatorët kryesor makroekonomik**

		2001	2002	2003
Rritja reale e BPV	%	4.6	4.5	4.2
Mesatarja e inflacionit	%	29.4	7.4	4.4
Bilanci i përgjithshëm qeveritar	% e BPV	-5.5	-4.9	-4.1
Eksporti	<i>bilion EUR</i>	10.3	10.8	11.1
Importi	<i>bilion EUR</i>	21.8	25.0	25.4
Bilanci i tregtisë me BE	<i>bilion EUR</i>	-6.2	-7.9	-2.6
Llogaritë rrjedhëse	% e BPV	-6.8	-9.0	-7.8
Investimet e huaja direkte	<i>bilion EUR</i>	2.8	2.1	2.9

Burimi: Komisioni evropian dhe IMF (Fondi monetary ndërkombëtar)

Shkallët e rritjes në Ballkanin Perëndimor janë puthitur gjatë dy-tri viteve të fundit. Rritja e vazhdueshme gjatë katër viteve të fundit është një shenjë nxitëse se këto ekonomi kanë potencial për një rritje të shpejtë gjatë një periudhe afatmesme dhe afatgjatë.

Procesi i dezinflacionit gradual në regjion ka arritur një progress të mëtutjeshëm gjatë vitit 2003, kryesisht për shkak të politikave të bazuara në pajtimin e jashtëm dhe në kornizat e një makroekonomie të matur. Këto masa janë përkrahur nga institucionet e Bretton Woods-it dhe nga ndihma në bilancin e pagesave nga BE.

Është vlerësuar se inflacioni për tërë Ballkanin ka mbetur rreth 4% nga fundi i vitit 2003.

Në vitin 2003, mesatarja e deficitit të përgjithshëm qeveritar në tërë regjionin pritet të ketë rënë në 4% të BPV, kryesisht për shkak të përshtatjeve të theksuara fiskale, prej më shumë se 3% të BPV në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Sipas mesatares, indeksi i të hyrave në raport me BPV, është vlerësuar se ka rënë prej 41.5% në 2002 në 40.7% në 2003, duke lënë barrën e përshtatjeve të parapara fiskale në zvogëlimin e shpenzimeve publike. Shpenzimet e publike si pjesë e BPV, bazuar në projektet e FMN-së, pritet që të zbresin nga 47% në 45% në 2003. Sidoqoftë, mesatarja e sektorit publik vazhdon të mbetet e lartë, duke e vonuar zhvillimin e sektorit privat si burim të rritjes.

Në përgjithësi, deficitet e mëdha tregtare tregojnë se Ballkani Perëndimor ende nuk i ka shfrytëzuar plotësisht përparësitë e masave asimetrike tregtare të ofruara nga BE, kryesisht për shkak të mungesës së kapacitetit prodhues, por edhe për shkak të aftësisë së pamjaftueshme për t'i përmbushur standardet cilësore të BE. Poashtu, pritet që eksporti i tërësishëm do të rritet më shpejt se importi. Sido që të jetë, deficitet tregtare kanë mbetur të larta për tërë regjionin dhe në bazë të Komisionit Evropian, pritet të jenë rreth 28% të BPV në fund të vitit 2003. Në anën tjetër, bilanci pozitiv i shërbimeve dhe transfereve rrjedhëse, kanë kontribuar në kufizimin e deficitit të tanishëm të llogarive me jashtë dhe sipas të gjitha gjasave kjo ka rënë në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2003. Dërgesat e parave e të të punësuarve jashtë vendit kanë rëndësi të veçantë për ekonominë e regjionit dhe janë të prezentuara nëpërmes transfereve private.

Reformat e orientuara kah tregut, përfshirë privatizimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore, gati janë kompletuar në shumicën e ekonomive të Ballkanit Perëndimor, përveq Kosovës ku aprocesi ndodhet në fazën fillestare të tij.

Procesi i liberalizimit të tregut që udhëhiqet nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore (EJL) ka pasur disa ndikime të rëndësishme. Tregu ndër-regjional mbetet mjaft i kufizuar dhe BE është partneri tregtar kryesor për Ballkanin Perëndimor (rreth 50% të eksportit). IRJ e Maqedonisë dhe Kroacia tashmë i kanë nënshkruar Marrëveshjet për Stabilizim dhe Asociacion (MSA) me BE, në prill respektivisht në tetor 2001. Negociatat me Shqipërinë kanë filluar në fillim të vitit 2003, ndërsa studimi i arsyeshmërisë për Bosnjën dhe Hercegovinën është finalizuar në nëntor të vitit 2003. Kroacia ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në BE në Shkurt të vitit 2003.

Përfundimisht, masat shtesë për përmirësimin e klimës ekonomike në regjion, rritja e besueshmërisë dhe zvogëlimi i rrezikut të investimeve nëpërmes luftës kundër korrupsionit, përfundimit të procesit të privatizimit dhe reformat në sektorin publik janë të nevojshme për përmirësimin e pasqyrës së ekonomive të Ballkanit Perëndimor.

## 4. Ekonomia e Kosovës

### 4.1 Bruto Produkti Vendor

Rritja e BPV në ekonominë e Kosovës së pasluftës është njëra ndër më të lartat në regjionin dhe në Evropë, por përkundër kësaj niveli i të ardhurave është ende një nga më të ultit në Evropë. BPV për person në vitin 2003, që është llogaritur të jetë 696 euro, është dukshëm më i ultë se nivelet e shënuara në vendet tjera të pasluftës në regjion. Norma e papunësisë, e llogaritur si 50%, vazhdon të jetë ndër më të lartat në regjion dhe një nga brengat kryesore për ekonominë e Kosovës.

**Tabela 2. Kosova: Indikatorët e zgjedhur të ngritjes së ekonomisë, në milion euro**

	2000	2001	2002	2003
<b>Agregatët kryesorë</b>				
BPV	746	1,154	1,279	1,317
BPV për person	410	626	684	696
Dërgesat e parave nga punëtorët me punë jashtë vendit	550	600	549	568
Ndihma e huaj (NH)	1,138	1,051	806	579
Kontributi direkt i NH në BPV	130	248	173	97
BPN	1,425	1,872	1,934	1,960
BPN për person (në euro)	783	1,015	1,034	1,036
Popullsia (në mijëra)	1,820	1,845	1,870	1,892
<b>Normat e rritjes reale (në %)</b>				
BPV	...	21.2	3.9	4.7
BPN	...	10.4	-1.9	2.4
Të hyrat e disponueshme të sektorit privat	...	-1.1	-9.4	-2.6
Konsumi i sektorit privat	...	1.5	1.4	-1.0
Importet komerciale	...	10.2	3.5	-7.4
BPV për person	...	19.5	2.6	3.5
BPN për person	...	8.9	-3.3	1.2
Të ardhurat private të disponueshme për person	...	-2.4	-10.7	-3.7
Konsumi privat për person	...	0.1	0.1	-2.2
IÇK (në %)	...	11.7	3.6	0.14
<b>Kursimet/Bilancet e Investimeve (në % të BPV)</b>				
Kursimet e ekonomisë vendore	-199	-115	-99	-85
Investimet Totale	66.9	57.7	48.3	40.5
Dërgesat e parave nga punëtorët me punë jasht shteti	73.7	52	42.9	43.2
Ndihma e huaj	152.5	91	63	44
Bilanci i llogarisë rrjedhëse me botën e jashtme (pas ndihmës së huaj)	-39.3	-29.3	-41.8	-38.6

Burimi: Vlerësimet/projektimet e stafit të FMN (Misioni i FMN, Nëntor 2003 – i azhuruar në Shkurt 2004)

Bazuar në vlerësimet<sup>3</sup> e kuadrit të FMN-së për vitin 2003 dhe rezultateve për periudhës së mëparshme, ekonomia e Kosovës është rritur 4.7% në vitin 2003, që shënon një ngritje krahasuar me 3.9% në vitin 2002. Përndryshe ai ka qenë mbi mesataren e shkallës së rritjes në Ballkanin Perëndimor prej 4.2% dhe mbi shkallën e rritjes prej 2% në vendet e OECD. Rritja e madhe ekonomike në kohën e fundit, ka qenë kryesisht e shtyer nga ndihma e madhe nga jashtë (rreth 44% e BPV) dhe të ardhurat nga diaspora kosovare (rreth 43% e BPV).

Siç mund të vërehet nga tabela e sipërme, ndihma e huaj ka pësuar rënie, gjatë periudhës së pasluftës, duke filluar me 152% të BPV në vitin 2000, për të shënuar rënie në 44% në vitin 2003.

<sup>3</sup> Rezultatet preliminare

Në anën tjetër, dërgesat e parave të punëtorëve të punësuar jashtë vendit kanë mbetur të pandryshuara sipas vlerave nominale, por kanë shënuar rënie si përqindje e BPV, duke rënë prej 73% në vitin 2000 në 43% në vitin 2002, për të mbetur të pandryshuara në vitin 2003. Këta faktorë theksojnë nevojën për një strategji ekonomike gjithëpërfshirëse, që do të mundësonte transformimin prej një ekonomie të varur nga ndihmat në një ekonomi me rritje të qëndrueshme. Në mënyrë që të arrihet kjo objektivë, nevojitet themelimi i një programi të zbatueshëm ekonomik dhe një bashkëpunim më i madh i ndër-sektorëve, nga të gjithë përbërësit e ekonomisë së Kosovës.

Sikur në vitin 2002, Bruto Produkti Nacional (BPN) në vitin 2003 tejkaloi BPV në shumë prej 643 milion euro, kryesisht nga dërgesat e parave të punëtorëve të punësuar jashtë vendit. Gjithashtu, BPN është rritur për 2.4% karahasuar me vitin paraprak, duke treguar një ndryshim nga rënja prej 1.9% e vitit 2002. Investimet e tërësishme vazhduan trendin e rënies nga periudhat paraprake, duke rënë në 40.5% të BPV. Një efekt i ngjashëm është vërejtur edhe në konsumin privat dhe importet komerciale, të cilat kanë rënë 1% dhe 7.4% respektivisht. Këto trende negative do të vazhdojnë që të ndikojnë në mënyrë të pafavorshme në rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës.

Me përjashtim të veprimtarisë ekonomike që udhëhiqet kryesisht nga financimi i donatorëve për rikonstruktimin e ndërtesave dhe infrastrukturës, përmirësimi i ekonomisë kosovare ka qenë shumë i ngadalshëm. Kjo mund t'i atribuohet vonësës së privatizimit dhe sektorit statik privat, i cili ka të bëjë kryesisht me tregtinë me pakicë dhe shërbimet, shkallës së vogël të përpunimit të produkteve bujqësore, përpunimit të pjesëve makinerike si dhe prodhimit të lëngjeve. Si rezultat i mungesës së progresit në industri, Kosova ka vazhduar të mvaret në masë të madhe në import dhe në ndihmën nga jashtë.

## 4.2. Paraja dhe Çmimet


Kosova nuk ka një politikë të pavarur monetare dhe të normës së këmbimit. Ekonomia në fakt është 'eurorizuar' që nga koha kur është lejuar përdorimi i lirë i DM në shtator të vitit 1999 dhe lejimi i Euros, në janar të vitit 2002. Pranimi i euros si valutë zyrtare është një nga zgjedhjet e politikave monetare të Kosovës.

Paraja në kuptim të gjerë ka osciluar shumë. Pas një ngritjeje fillestare prej 22.1% në mes të viteve 2000 dhe 2002, ka pësuar rënie në vitin 2003. Këto oscilime, mund të spjegohen nëpërmes dy trendeve të ndryshme: ndryshimi në paranë në qarkullim dhe ndryshimit të depozitëve. Vit pas viti paraja në qarkullim ( $M_0$ ) kanë rënë 34.16% në 2001, është rritur 17.8% në 2002 dhe kanë rënë përsëri për 51.3% gjatë vitit 2003. Ky trend i përgjithshëm i rënies mund të spjegohet në bazë të dy faktorëve: së pari, rritja e vazhdueshme e depozitëve, 372.4% në mes të vitit 2000 dhe 2003; dhe së dyti, bilanci tregtar negativ i lartë. Në vitin 2003, ndaras vit pas viti është shënuar rritje prej rreth 21% në depozitët bankar.

Që nga viti 2002, agregati monetar  $M_1$  ka ndjekur një trend të ngjashëm me  $M_0$ , përkundër rritjes në llogaritë rrjedhëse (depozitët e transferueshëm), e cila rritje është tejkaluar nga rënia e parasë së gatshme në qarkullim.

Trendi i  $M_2$ , që konsiderohet si një definicion i përshtatshëm i parasë së gjërë, tregon një rënie më të vogël sesa  $M_1$ , derisa depozitët e kursimeve janë rritur me një ritëm më të shpejt se llogaritë rrjedhëse bankare (depozitët e transferueshëm).

Grafiku 1. Agregatët monetar, në mijëra euro



M0 = paraja në qarkullim  
M1 = M0 plus depozitët e transferueshme  
M2 = M1 plus depozitët e afatizuar.

Një rritje e madhe e depozitëve gjatë një periudhe njëvjeçare që është shënuar në vitin 2001, është si rezultat i zhvillimit të shpejtë të sistemit bankar dhe konvertimit në euro. Niveli i pandryshueshëm i depozitëve gjatë vitit 2002 dhe rritja e mëtutjeshme prej 21% gjatë vitit 2003, vërteton rritjen e besueshmërisë në sistemin bankar.

Kosova vazhdon të mbetet në një pozitë mjaft të pazakonshme sa i përket kreditimit neto të ekonomisë vendore<sup>4</sup>. Kreditë vendore në Kosovë janë përherë negative (rreth 123 milion euro në fund të vitit 2003). Ky është një rezultat i drejtëpërdrejtë i politikës së matur fiskale dhe faktit se BPK nuk emeton para dhe nuk është e autorizuar të japë kredi.

<sup>4</sup> Shuma në neto e kërkesave për qeverinë (përfshirë llogaritë depozitare të UNMIK-ut) dhe kërkesave për ekonominë vendore


Tabela 3. Pasqyra monetare, në mijëra euro

Përshkrimi	2000	2001	2002	2003
	Dhjetor	Dhjetor	Dhjetor	Dhjetor
<b>Mjetet jashtë neto</b>	<b>122,577</b>	<b>583,134</b>	<b>649,305</b>	<b>696,751</b>
BPK	52,116	293,470	345,226	453,418
Mjetet	61,697	296,235	345,773	453,990
Obligimet	9,581	2,765	547	572
Bankat komerciale	70,461	289,664	304,079	243,333
Mjetet	83,099	308,593	328,322	272,436
Obligimet	12,638	18,929	24,243	29,103
<b>Mjetet në vend neto</b>	<b>-5,770</b>	<b>-32,091</b>	<b>177,499</b>	<b>123,014</b>
Neto kërkesat ndaj qeverisë	-8,741	-72,066	-258,917	-347,827
Depositet nga Qeveria	-8,741	-72,066	-258,917	-347,827
Neto kërkesat ndaj sektorëve tjerë publik	0	0	0	0
Neto kërkesat ndaj institucioneve financiare	0	0	0	0
Kërkesat ndaj sektorit privat	3,148	25,916	86,498	232,773
Zërat tjerë neto	-177	14,059	-5,080	-7,960
<b>Paraja e gjërë</b>	<b>743,314</b>	<b>906,254</b>	<b>907,672</b>	<b>741,516</b>
Paraja në qarkullim*	637,229	419,578	494,130	240,337
Depozitët e përfshirë në parane e gjerë	106,085	486,676	413,542	501,179
Llogaritë rrjedhëse - ndërmarrjet	77,284	144,047	163,348	160,404
Llogaritë rrjedhëse - ekonomia shtëpiake	21,189	217,841	121,913	143,311
Llogaritë e afatizuara dhe të kursimeve - ndërmarrjet	4,579	31,318	23,921	74,758
Llogaritë e afatizuara dhe të kursimeve -ekon. familjare	3,034	93,471	104,359	122,706

\*Paraja në qarkullim është në process të vlerësimit nga misioni i FMN/AT, mbi Statistikat Monetare dhe Financiare, bazuar në importet/eksportet e parave të gatshme të kryera nga BPK dhe bankat komerciale dhe të dërgesat e punëtorëve , dhe kjo mund të ndryshoj.

Përdorimi i euros ka mundësuar një stabilizim të shpejtë makro-ekonomik pas shumë vitesh ballafaqimi me një inflacion shumë të lartë në ish Jugosllavi. Grafiku i mëposhtëm paraqet Indeksin e Çmimit të Konsumit (IÇK) për ekonominë e Kosovës.

Grafiku 2. Indeksi i Çmimit të Konsumit (IÇK), ndryshimet në përqindje



Burimi i të dhënave: Enti Statistikor i Kosovës

Rritjet e rëndësishme fillestare të çmimeve në norma vjetore dyshifrore, të përcjellura në 2001-2002 me një stabilizim gradual të çmimeve, vazhduan që të zvoglohen deri në një përqindje mesatare të inflacionit të afërt me zero përqind në vitin 2003.

Në grafikun e mësipërm, vija që mbulon periudhën prej majit deri në dhjetor të vitit 2003, paraqet ndryshimet mujore të inflacionit në krahasim me muajt e njëjtë të vitit paraprak. Grafiku tregon se Kosova është duke përjetuar një inflacion shumë të ultë, me maksimumin prej 2.2% gjatë muajit nëntor dhe një deflacion të ultë prej 0.3% në gusht, e përshtatur për sezonalitet duke krahasuar IÇK-në e muajit të caktuar me IÇK-në e muajit të njëjtë në vitin paraprak. Nga pikëpamja makroekonomike, kjo do të thotë se nuk ka stimulim për investime të mëtutjeshme, që më pastaj sygjeron në stagnim të rritjes së BPV në të ardhmen.

### 4.3. Ndërmjetësimi financiar

Katër vitet e fundit kanë dëshmuar një zhvillim të shpejtë të ndërmjetësimit financiar në Kosovë, veçanërisht në sektorin bankar.

**Tabela 4. Ndërmjetësimi financiar, fundi i vitit, në milion euro, përveç nëse parqitet ndryshe**

	2000	2001	2002	2003
Bankat komerciale, numri i degëve	5	24	112	148
IMF-të dhe inst. Fin. jobankare, numri i degëve	10	29	40	25
Mjetet e bankave komerciale,	103	519	471	581
Prej të cilave: kamatë prurëse, %	72	47	80	79
Prej të cilave: kreditë,	3.1	26	86.5	232.8
Obligimet e bankave komerciale,	96.8	498.5	438	536
Prej të cilave: Depozitët	93	492	427	516
Prej të cilave: Përsonat juridik	60	106	184	230
Ekonomitë familjare	24	312	228	266
Depozitët në të parë	85	366	296	316
Depozitët e afatizuar	8	126	131	200
Kapitali i aksionarëve	6.2	20.5	33	45
Kreditë e bankave komerciale	3	26	87	233
Operacionet ndërbankare, numri i transakcioneve		5,124	75,763	164,207
Operacionet ndërbankare, shuma totale,		86	841	1,416
Mesatarja e shumës vjetore të mjeteve,		260	439	531
Koeficienti i rrotullimit: operacionet mdaj mjeteve		0.33	1.91	2.67
Transferet telegrafike (komerciale): rrotulimi i tërësishëm	468	1,141	1,591	2,591
Hyrëse (hyrje) – bruto	293	630	854	1,286
Dalëse (dalje) – bruto	-175	-511	-737	-1,305
Hyrëse (hyrje) – neto	117	119	118	-19
Eksporti i tërësishëm i mallërave komerciale - bruto	3	23	27	31
Importi i tërësishëm i mallërave komerciale - bruto euro	-1,134	-1,281	-1,349	-1,288
Importi i tërësishëm i mallërave komerciale – neto	-1,131	-1,285	-1,322	-1,257
Indeksi: bruto transferet e dala në bruto importet, %	15.4	39.9	54.6	101.3

Zgjerimi i aktiviteteve bankare është ilustruar me rritjen e numrit të lokacioneve bankare (bankat komerciale dhe degët e tyre) – gati pesë herë më shumë në periudhën Dhjetor 2000 – Dhjetor 2001 dhe prapë ka pasur një rritje për 4.6 herë më të madhe në periudhën Dhjetor 2001 – Dhjetor 2002

Numri i tërësishëm i lokacioneve të bankave është rritur edhe më shumë në vitin 2003, kështu që në Dhjetor të vitit 2003 ka arritur numrin 148.

Numri i tërësishëm i operacioneve ndërbankare është rritur gati dhjetëfish në periudhën 2001-2002. Ky numër gati është dyfishuar në vitin 2003, me një numër të transakcioneve dyfish më shumë.

Gjatë kësaj kohe, proporcioni (raporti) i operacioneve bankare në mjete është rritur tetë herë, prej 0.33 në vitin 2001 në 2.67 në fund të vitit 2003.

Këto shifra tregojnë ngritjen e rëndësisë së sistemit bankar në Kosovë dhe rolin e tij kyç në rimëkëmbjen e qëndrueshme të ekonomisë të Kosovës.

Të dhënat poashtu tregojnë se bankat kanë mundur pagesat për një pjesë më të madhe të importeve. Bazuar në tabelën e sipërme, përqindja e transfereve dalëse bruto të importeve bruto ka qenë 101.3% në vitin 2003, apo 46.7% më i lartë se vitin paraprak. Ky është një tregues i fuqishëm i rritjes së rolit të sektorit bankar në Kosovë, posaqërisht në lehtësimin e blerjeve dhe shitjeve ditore, transfereve të parave të gatshme dhe operacioneve të tjera financiare.

Një rritje e shpejtë e depozitëve bankarë gjatë vitit 2000 dhe 2001, ka reflektuar në mes tjerash edhe një rritje të kursimeve nga popullsia. Një reduktim prej 13.2% në bilancin e llogarive depozitare të vitit 2002, mund t'i atribuohet rritjes së shpenzimeve. Përkundër pritjeve të mëhershme për një rënie të kursimeve gjatë vitit 2003, si pasojë e zvogëlimit të aktiviteteve të donacioneve dhe parave të dërguara nga Diaspora, depozitët bankar janë rritur 20.1% gjatë vitit.<sup>5</sup> Kjo mund të spjegohet si rezultat i efektshmërisë ekonomike dhe si një rritje pasuese në aftësitë kursyese të korporatave jo-financiare dhe gjithashtu edhe si rritje e besueshmërisë në sektorin bankar të Kosovës.

Ndryshimi në strukturën e depozitëve nuk ka qenë i njejtë për depozitët në të parë sikurse edhe për depozitët e afatizuar. Depozitët në të parë kanë osciluar, duke paraqitur në fillim rritje prej 330% në vitin 2001, duke vazhduar me një rënie të vogël prej 19% në vitin 2002, e pastaj duke u rritur rreth 7% në vitin 2003. Depozitët e afatizuara kanë ruajtur një trend të lartë të një rritjeje substanciale në vitin 2001, duke vazhduar me një rritje të vogël prej 4% në vitin 2002. Një efiukasitet shumë më i mirë është evidentuar në vitin 2003 me një ngritje prej 52% gjatë periudhës njëvjeçare, që i atribuohet kryesisht rritjes prej 212% në depozitët e afatizuar dhe ndërmarrjet jo-financiare. Një nga arsytet e një rritjeje të këtillë, mund të ketë qenë dëshira e bizneseve për krijimin e kredibilitetit me bankat komerciale për të pasur një çasje më të lehtë në kreditë bankare, në të ardhmen.

Përkundër rreziqeve që përcjellin kreditimin e sektorëve privat në Kosovë nga bankat, edhe pse jo me rendësi aq të madhe, ky kreditim i sektorëve nga ana e bankave paraqet një trend pozitiv. Në vitin 2000 kreditimi i sektorit privat ka qenë vetëm 3% e mjeteve të tërësishme të bankave komerciale, derisa në vitin 2001 kjo është rritur në 5%. Në vitin 2002, kjo është rritur edhe më tutje për të arritur në 18%. Viti 2003 është karakterizuar nga një rritje e kundersueshme e kreditimit të bankës për sektorin privat, me një rritje të shumës së kredive në 40.2% të mjeteve të tërësishme të bankave.

Raporti i kredive ndaj depozitëve ka arritur në 45% në vitin 2003, një përmirësim në krahasim me 21% gjatë vitit 2002. Sidoqoftë, kreditë janë kryesisht të një kohëzgjatjeje të shkurtë (deri në një vit) dhe me norma relativisht të larta të kamatës. Përqindja e këtyre kredive në raport me BPV në fund të vitit 2003 ka qenë ende e vogël (vetëm 12.75%).

Sidoqoftë, sistemi bankar dhe ndërmarrjet jo-financiare, ende nuk janë të gatshme të inicojnë apo të mbështesin projekte të investimeve të mëdha në sektorin privat. Gjatë katër viteve të fundit, ka pasur investime të vogla private në Kosovë e të cilat mund t'i shtojnë aktivitetet ekonomike dhe të mundësojnë një rritje të qëndrueshme.

Rreth 80% të kredive bankare janë të një natyre afat-shkurtër dhe nuk mund të shfrytëzohen si bazë për investime afatgjata. Në anën tjetër, shumica e depozitëve bankar janë për një periudhë njëvjeçare dhe si të tilla nuk mund të sigurojnë kredi afatgjata që do të mbështesnin investimet.

<sup>5</sup> Këta numra shprehin gjendjen kumulative të fundvitit, kështuqë ato nuk paraqesin informatë rreth ndryshimeve në llogaritë e depozitëve gjatë vitit përkatës.

**Tabela 5.****Kreditë e bankave komerciale sipas aktiviteteve, fund i vitit, në mijëra euro**

	2000	2001	2002	2003
Bujqësia	0	141	1,510	4,558
Ndërtimtaria	0	1	1,811	1,619
Tregtia	2,187	13,960	50,532	113,531
Shërbimet, Turizmi	565	3,688	14,633	71,606
Industria	396	0	3,154	16,241
Patundshmëria / Ndërtimtaria	0	194	474	1,850
Administrata, Shërbimet tjera publike	0	0	3,822	191
Të tjera	0	7,933	10,562	23,177
<b>Gjithsej Kreditë</b>	<b>3,148</b>	<b>25,917</b>	<b>86,498</b>	<b>232,773</b>

Kreditë e bankave komerciale kanë qenë kryesisht të koncentruara në aktivitetet tregtare, dhe kanë shënuar një rritje prej 102% në vitin 2003 krahasuar me fundin e vitit 2002. Kreditimi i sektorit të shërbimeve dhe atë të turizmit kanë qenë posaqërisht i madh dhe ka arritur shumën prej 71.6 milion euro nga fundi i vitit 2003, 5 herë më shumë se në vitin 2002. Edhe pse kreditë për industri kanë shënuar një rritje të ngjashme, kanë arritur një shumë prej vetëm 16.2 milion euro dhe për këtë arsye ky nuk ka paraqitur ndonjë investim apo kontribut të theksuar në rimëkëmbjen e ekonomisë apo në krijimin e vendeve të reja të punës në Kosovë.

#### 4.4. Tregtia e jashtme dhe Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave të Kosovës mund të karakterizohet si mjaft i mjerë . Sikurse edhe në vitet e mëparshme ashtu edhe në vitin 2003, ekonomia e Kosovës ka vazhduar të mbështetet kryesisht në ndihmën e huaj, paratë e dërguara nga puntorët kosovar me punësim jashtë vendit si dhe nga importi.

Paratë e dërguara nga puntorët me punësim jashtë vendit kanë qenë relativisht të pandryshueshme, dhe sikurse në të kaluarën, ato kanë ndihmuar mbijetesën e 75% të familjeve kosovare.

Në vitin 2003, raporti i parave të dërguara nga puntorët me punësim jashtë vendit ndaj BPV ka mbetur pothuajse në të njëjtin nivel prej 43% të BPV. Paratë e dërguara janë përdorur kryesisht për konsum personal dhe për riparimin e shtëpive private, kështu që nuk kanë pasur ndonjë ndikim të drejtpërdrejt në investime.

Ndihma e huaj, ka rënë deri në 579 milion<sup>6</sup> euro por ende vazhdon të mbetet forca kryesore shtytëse për rritjen e ekonomisë gjatë vitit 2003. Të dhënat nga viti 2002, e poashtu edhe vlerësimet preliminare për vitin 2003 të përgatitura nga stafi i FMN-së, tregojnë se ndihma e huaj ka humbur rreth 20% të rëndësisë së vetë në BPV të Kosovës, duke rënë nga 63% në vitin 2002 në 44% të BPV në vitin 2003.

<sup>6</sup> Vlerësimet e bëra nga stafi i misionit të FMN – Nëntor 2003, përpunuar në Janar të vitit 2004.

**Tabela 6. Kosovë: Bilanci i pagesave, në milion euro, përveç nëse paraqitet ndryshe**

	2000	2001	2002	2003*
<b>Bilanci tregtar</b>	<b>-1,379</b>	<b>-1,300</b>	<b>-1,236</b>	<b>-1,157</b>
Eksporti	169	202	240	232
Importi	-1,547	-1,502	-1,476	-1,389
<b>Sherbimet jo-faktoriale</b>	<b>-603</b>	<b>-689</b>	<b>-653</b>	<b>-483</b>
Marrjet (hyrjet)	30	32	29	36
Pagesat	-633	-720	-682	-519
<b>Të ardhurat Faktoriale</b>	<b>679</b>	<b>717</b>	<b>654</b>	<b>643</b>
Dërgesat e parave nga punëtorët me punë jasht shteti	550	600	549	568
Factor income nga punësimet nga donorët	129	117	105	75
<b>Transferet</b>				
<b>Ndihma e huaj</b>	<b>1,138</b>	<b>1,051</b>	<b>806</b>	<b>579</b>
(sipas % së BPV)	152.5	91.0	63.0	40.7
PIP	571	532	375	174
Prej të cilave UNMIK-u	413	449	388	368
<b>Bilanci i llogarisë rrjedhëse me jasht (pas granteve)</b>	<b>-165</b>	<b>-221</b>	<b>-429</b>	<b>-418</b>
(sipas % së BP)	<b>-22.1</b>	<b>-19.1</b>	<b>-30.8</b>	<b>-29.4</b>
<b>Bilanci i llogarisë së kapitalit</b>	<b>165</b>	<b>221</b>	<b>429</b>	<b>418</b>
Pjesmarrja e kapitalit të donatorëve	42	32	10	1
Ndryshimet në depozitët e jashtëm të qeverisë (- rritja)	-73	5	78	13
Ndryshimet në paratë në qarkullim (- rritja)	-84	218	-75	254**
Ndryshimi në MNH në sistemin bankar	-120	-461	-66	-47
Ndryshimi në mjetet e huaja të TKPK-së	0	0	0	-35
Gabimet dhe mospërfshirjet	400	427	482	197
Bilanci i përgjithshëm	0	0	0	0
<b>Neto ndryshimi në rezervat ndërkombëtare (- rritja)</b>	<b>234</b>	<b>679</b>	<b>701</b>	<b>587</b>
Rezervat zyrtare	92	87	32	32
Neto rezervat ndërkombëtare të sistemit banker	142	592	668	555

Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-së.

\*Të dhënat e vitit 2003 janë në procedurë të rishikimit dhe mund të ndërrohen.

\*\*Ndryshimet në qarkullimin e parave janë të llogaritura nga importi dhe eksporti i parave të gatshme vetëm nëpërmes sektorit bankar kështu që nuk janë marrë në konsiderim importet/eksportet e paregjistruar të parave të gatshme.

Kjo tregon se varësia e Kosovës nga ndihmat e huaja mbetet e lartë edhe pse po zvoglohet vit pas viti. Duke përcjellur zvoglimin e përgjithshëm të ndihmës së huaj, llogaria rrjedhëse me jasht tregon një deficit prej 29.4% të BPV në vitin 2003, një gjendje paksa më të mirë se vitin e kaluar.


Bilanci tregtar i Kosovës mbetet një shkak për brengosje dhe në vitin 2003 nuk ka shfaqur asnjë shenjë përmirësimi të dukshëm. Të dhënat nga viti 2003 tregojnë se ekonomia e Kosovës mund të mbulojë më pak se një të gjashtëm e importeve të saj nga eksporti, dhe se deficitin bilancor llogaritet për më shumë se 84% të BPV.

Për më tepër, të dhënat e fundit tregojnë se eksporti i rregullt (duke përjashtuar eksportin që ka të bëjë me shpenzimet e KFOR-it dhe të qytetarëve të huaj në Kosovë), që arrin 36.2 milion euro në 2003, në fakt mbulon vetëm 2.6% të importit kosovar.

Të dhënat e mësipërme tregojnë mjerimin e thellë të bilancit të pagesave me jasht të Kosovës. Prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme për Kosovën që të përgatisë një politikë që do të favorizonte investimet në kapacitetet e prodhimit, që gradualisht të zëvendësojë importin me

prodhime vendore të Kosovës. Përndryshe, për shkak të disa kushteve specifike financiare (Kosova nuk ka të drejtë të emetoj para, kështu që furnizimi me para varet plotësisht nga ndihmat e huaja dhe dërgesat e parave të punëtorëve me punësim jashtë vendit) dhe për shkak të një mosbarazimi ekstrem në tregtinë e jashtme, për një kohë shumë të shkurtër, Kosova mund të përballet me rënie të parasë në qarkullim dhe çdo lloj aktiviteti ekonomik do të vështirësohet shumë.


**Grafiku 3. Tregia e jashtme: Eksporti i mallrave të zgjedhur, në milion euro**



Burimi i të dhënave: Shërbimi Doganor i Kosovës

Në anën tjetër, kthimi i eksporteve në bilancin tregtar të Kosovës tregon se janë disa shenja pozitive në strukturën bazike të ekonomisë. Përveq mallërave të klasifikuara si eksport tjetër, gjithsej eksporti i lëkurës, birrës, verës dhe kërpudhave paraqet 19.9% të eksportit, përderisa mbeturinat metalike me 16.5% paraqesin një përmirësim në vitin 2003. Mallrat kryesore të eksportuara në vitin 2003 janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

**Figura 4. Tregia e jashtme: Eksporti i mallrave të zgjedhura kryesore, në milion euro**




Burimi i të dhënave: Shërbimi Doganor i Kosovës dhe MFE - MEPD

Përmirësimi shtesë dhe i rëndësishëm i eksportit do të jetë çështje kyçe për vitet e ardhshme. Sa i përket importit, importi i ushqimit dhe duhanit është rritur prej 20.4% sa ka qenë në vitin 2002 në 24% në vitin 2003 dhe nuk është në pajtim me rëndësinë e bujqësisë për ekonominë e Kosovës. Kjo përqindje e lartë duhet dhe ka gjasa që të zbrësë në vitet e ardhshme. Kjo mund të arrihet duke zëvendësuar importin me prodhime vendore që mund të arrihen me anë të prodhimit

bujqësor, si sektor primar, që do të stimulohej nëpërmes aplikimit të politikave tatimore. Një masë e tillë jo vetëm që do të përmirësonte dukshëm bilancin tregtar por gjithashtu do të ndihmonte në zvogëlimin e shkallës së lartë të papunësisë në Kosovë.

**Grafiku 5. Tregtia e jashtme: Importet sipas grupit të artikujve, në milion euro**




Burimi i të dhënave: Shërbimi Doganor i Kosovës dhe MFE - MEPD

Një fenomen tjetër brengosës është zvogëlimi i importit të makinerisë gjatë vitit 2003. Ky është rezultat i më pak investimeve në aktivitetet prodhuese, që nuk është shënjë e mirë për rritjen e ekonomisë në vitin e ardhshëm. Rënia në importimin e makinerisë është e shkaktuar nga 'kushtet e rënda për investime', përfshirë koston e lartë të kredive, natyra e shkurtë e kredive si dhe dogana e lartë për importin e makinerisë.

Partnerët kryesor tregtar të Kosovës janë BE dhe IRJM. Përderisa tregtia me BE, Turqinë dhe Bosnjën e Hercegovinën po rritet, tregtia me IRJM dhe Serbinë ka shënuar rënie. Marëdhëniet tregtare me Slloveninë dhe Kroacinë poshtu po rriten për shkak të pranisë së tyre më të madhe në tregun kosovar pas hapjes së përfaqësive të tyre tregtare në Kosovë (të përfshira në rubrikën –të tjera- në grafikun e mëposhtëm).

**Grafiku 6. Tregtia e jashtme: Importet sipas vendit të ngarkesës, në milion euro**




Burimi i të dhënave: Shërbimi Doganor i Kosovës

Të dhënat mbi strukturën gjeografike të eksporteve sipas destinacionit të vendeve ende nuk disponohen.

Struktura gjeografike duket e paqartë për shkak të mungesës së të dhënave të detajzuara të importeve sipas origjinës së vendit. Në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë që është e mundur nga marrëveshja për tregti të lirë në mes IRJM dhe RFJ (tatimi doganor vetëm 1%) që është nënshkruar në periudhën e paraluftës, certifikatat maqedonase mbi origjinën e mallit shpesh përdoren për mbulimin e mallërave nga vendet tjera, duke i shtrembëruar të dhënat në këtë mënyrë.

Një faktor me rëndësi për t'u përmendur kur flasim për tregtinë e jashtme është Marrëveshja për tregti të Lirë, e nënshkruar në mes të Shqipërisë dhe Kosovës në vitin 2003. Kjo është marrëveshja e parë e këtij lloji dhe parqet një epokë të re në krijimin e marrëdhënieve të mira me shtetet fqinje dhe me ekonominë e tregut të hapur regional. Marrëveshje të ngjashme me vende të tjera janë duke u shqyrtuar, por duke pasur parasysh strukturën e burimit të të hyrave në buxhetin e Kosovës, duhet të mirren parasysh edhe pasojat e marrëveshjeve të tilla të tregtisë së lirë, në buxhetin e Kosovës.

**Grafiku 7. Euro në këmbim me valutat tjera të zgjedhura**



Burimi: [www.oanda.com](http://www.oanda.com)

Tregjet e valutave të huaja në vitin 2003, janë karakterizuar me një sforcim të përgjithshëm të euros në krahasim me valutat tjera kryesore, veqanërisht në krahasim me dollarin amerikan. Sipas grafikun së mësipërm, vlera e euros është ngritur 23% në krahasim me dollarin amerikan si pasojë e presionit të shkaktuar nga deficiti amerikan në llogarinë rrjedhëse me botën e jashtme. Gjithashtu, është më i lartë për 9.4% sesa Funta Sterling. Poashtu një ngritje e vogël mund të vërehet në krahasim me Frankun zviceran dhe Tollarin sloven. Për këtë arsye, ekonomia e Kosovës ka përfituar nga rritja e vlerës së euros, për shkak se BPV i Kosovës është pothuajse i barabartë me importet e saja.

#### 4.5. Politika fiskale

Të hyrat e përgjithshme vjetore në vitin 2003 kanë tejkaluar të hyrat e vitit 2002 për 16%. Pjesa më e madhe e të hyrave të qeverisë është grumbulluar në kufi dhe paraqet rreth 71.9% të të hyrave të tërësishme. Tatimet komunale janë rritur poashtu, në krahasim me vitin e kaluar (36.2%).

Tabela 7. Buxheti i konsoliduar i Kosovës, fundi i vitit, në milion euro

	2000	2001	2002	2003
<b>Të hyrat</b>	<b>289.5</b>	<b>355.9</b>	<b>508.4</b>	<b>589.65</b>
Qeveria qendrore	128.5	308.0	478.0	562.35
Prej të cilës: TVSH në import	63.4	127.2	169.0	180.6
Dogana	32.3	47.6	67.5	72.34
Akciza në kufi	19.5	77.0	125.6	171.34
Tatimet komunale vetanake	0.0	15.0	19.9	27.31
<b>Shpenzimet</b>	<b>234.9</b>	<b>281.3</b>	<b>429.2</b>	<b>570.8</b>
Shpenzimet e tanishme	234.9	274.6	413.3	449.26
Pagat	92.3	109.5	130.9	145.7
Mallërat dhe shërbimet	73.4	96.8	148.8	173.36
Prej të cilave: <u>Grantet e Zotuara nga Donatorët</u>	31.1	35.5	26.9	25.16
Transferet dhe subvencionet	64.8	61.6	77.0	118
Prej të cilave: ndërmarrjeve shtetërore <sup>1</sup>	34.2	27.6	18.0	36.4
Prej të cilave për investim	17.0	14.0	16.0	27.5
Të tjera	4.4	6.7	56.6	12.2
Shpenzimet kapitale	0.0	6.6	15.9	89.32
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>-106.4</b>	<b>41.7</b>	<b>68.7</b>	<b>18.82</b>
Financimi	106.4	-41.7	-68.7	-18.82
Grantet bugetore	160.6	83.7	39.0	29.15
Grantet e paracaktuara nga donatorët	40.0	41.0	20.9	29.15
Përkrahja bugetore	120.6	41.1	18.1	0
Të tjera (+ tërheqjet)	-54.2	-125.5	-107.7	-47.97
Ndryshimi në bilancet e fondeve të paracaktuara	-8.9	-7.2	6.0	0.0
Ndryshimi në bilancet tjera bankare	-45.3	-118.3	-113.7	-47.97
			<i>Në % të BPV</i>	
<b>Të hyrat</b>	<b>38.8</b>	<b>30.8</b>	<b>39.7</b>	<b>44.8</b>
<b>Shpenzimet</b>	<b>31.5</b>	<b>24.4</b>	<b>33.6</b>	<b>43.3</b>
Shpenzimet e tanishme	31.5	23.8	32.3	34.1
Shpenzimet kapitale	-	0.6	1.2	6.8
<b>Bilanci i përgjithshëm (para granteve të donatorëve )</b>	<b>-14.3</b>	<b>3.6</b>	<b>5.4</b>	<b>1.4</b>
Grantet bugetore	21.5	7.3	3.0	2.2
<b>Bilanci i përgjithshëm (pas granteve të donatorëve )</b>	<b>7.2</b>	<b>10.9</b>	<b>8.4</b>	<b>3.6</b>

Burimi: MFE - MEPD dhe misioni FMN (Nentor 2003 – përpunuar në shkurt 2004)

<sup>1</sup>Në vitin 2002 hyjnë edhe shpenzimet e njëherëshme që i janë dhënë KEK-ut për riparim, me rastin e goditjes nga rrufeja.

Bazuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, të hyrat në dhjetor kanë qenë mbi mesataren mujore. Kjo kryesisht për shkak të transferimit të fondeve komunale në thesar si dhe pranimi i fondeve që kanë të bëjnë me shitjen e Njesisë së Përkohshme Kreditore (NjPK), gjë që ka stërritur të hyrat e patatueshme në vlerë prej 5.7 milion euro.

Bazuar në politikën e matur fiskale, pozita fiskale e Kosovës në 2003 ka mbetur e qëndrueshme me një suficit buxhetor, edhe në vitin e tretë vijues. Niveli i suficitit të tërësishëm buxhetor (me përjashtim të granteve buxhetore) është rritur prej 41.7 milion euro (2.4% e BPV) në 2001 në 68.7 milion euro (3.5% e BPV) në 2002. Suficiti në vitin 2003 ka pasur rritje të sërishme, të vlerësuar në 75 milion euro (5.7% e BPV)<sup>7</sup>.

Për pjesa e TVSH-së vendore në TVSH-në e të hyrave të tërësishme ka mbetur në një nivel të ultë, vetëm 16.2%.

<sup>7</sup> Këto shifra nuk janë përfundimtare dhe mund të ndryshojnë pas raportit final të MFE.

Përderisa të hyrat janë rritur për 16% në 2003 sipas bazës vjetore, shpenzimet janë rritur për 33% krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rritje e madhe e shpenzimeve është shkaktuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve kapitale, prej 15.9 milion euro në 2002 deri në 89.3 milion euro në vitin 2003.

Buxheti për vitin 2004 është buxheti i parë që do të financohet tërësisht nga të ardhurat vendore. Siç shihet nga tabela e lartëshënuar, shpenzimet në buxhetin e përgjithshëm të Kosovës, në vitin 2003 janë dy herë më të mëdha në krahasim me vitin 2001. Në anën tjetër, shpenzimet e UNMIK-ut, PIP/ OJQ dhe KFOR-i kanë rënë dukshëm.



## II. Aktiviteti i BPK-së


### Hyrje

Aktivitetet e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK) shtrihen në dy fusha kryesore me sa vijojnë:

- BPK kryen funksionet e zakonshme të një banke qendrore (operacionet bankare dhe shërbimet e përgjithshme të kamatës), dhe
- BPK vepron si Autoritet i Shërbimeve Financiare të Kosovës

Në prag të vitit 2004, është bërë e njohur nevoja për një strukturë të re organizative dhe skema e re organizative (e paraqitur më poshtë) është implementuar më 1 janar 2004. Kjo strukturë formale ka objektivat me sa vijojnë:

- Progresi i mëtejshëm i procesit të kosovarizimit; dhe,
- Sigurimi i aplikimit të "Praktikës më të mirë" në qeverisjen e BPK-së si bankë qendrore.



## 1. Operacionet Bankare

Më 1999, Marka Gjermane (DEM) u bë një valutë e zgjedhur për Kosovën, ndërsa Regullorja e UNMIK-ut 1999/04 dhe Udhëzimi Administrativ Nr.1999/02 formalizuan këtë vendim. Por, me konvertimin e DEM në euro, euro u bë valutë e zgjedhur në Kosovë. Udhëzimi Administrativ Nr.2001/24 formalizoi këtë vendim.


Sipas këtij vendimi, BPK-ja nuk emeton para dhe për këtë arsye nuk ka politikë monetare apo kreditore në kuptimin klasik. Megjithatë kryen funksione të tjera që zakonisht janë të shoqëruara me operacionet e bankës qendrore. Këto përfshijnë:

- Furnizimi dhe mirëmbajtja e valutës fiduciare;
- Sistemi i Pagesave;
- Bankier për qeverinë;
- Shërbime të tjera të interesit të përgjithshëm; dhe
- Këshilltar i marrësve të vendimit publik.

### Furnizimi dhe mirëmbajtja e valutës fiduciare

Sa i përket **furnizimit me valutë**, BPK është përgjegjëse për të siguruar se ekonomia e Kosovës furnizohet në sasi dhe cilësi të mjaftueshme të euro kartëmonedhave dhe monedhave si dhe me denominime adekuate duke përbushur nevojat e ekonomisë kosovare në çdo kohë. Të dhënat e paraqitura në grafikun më poshtë ilustrojnë se struktura e denominimeve të valutës është kryer mirë nga BPK-ja e cila i përbush nevojat reale të ekonomisë së Kosovës.


**Grafiku 8. Sasia e kartëmonedhave në BPK**



Derisa denominimet e vogla të kartmonedhave në 2003 janë sjellur më pak në BPK. Sasia e të gjitha denominimeve në monedha (përveç 0.05 centë) është rritur. Në vitin 2003, ne vërejtëm se

shumë tregtar me pakicë janë ankuar rreth mungesës së monedhave në qarkullim, por asnjë kërkesë nuk është bërë nga bankat komerciale. BPK-ja është e gatshme t'i furnizojë të gjitha palët e interesuara me denominime të mjaftueshme në monedha.

**Grafiku 9. Sasia e monedhave në BPK**



Në fakt, BPK-ja nuk ka fuqi të kontrollojë sasinë e valutës fiduciare, dhe një shumë e konsiderueshme e parave të gatshme është sjellë në Kosovë kryesisht nga punëtorët që punojnë jashtë vendit dhe kanaleve të tjera jozyrtare. BPK në kohë të fundit ka filluar hulumtimin mbi vlerësimin e parasë në qarkullim, hulumtim ky i mbështetur edhe nga eksperti i FMN-së.


Sa i përket **anës së mirëmbajtjes** së valutës fiduciare, BPK në 2003 ka kryer shumë operacione me para të gatshme (depozitë, tërheqje, dhe eksportin/importin e parasë së gatshme) që do të thotë se ka procesuar më tepër se 14 milion euro-kartmonedha dhe më tepër se 4.5 milion euro-monedha. Nuk është vetëm çështje e numërimit të shumës së kartmonedhave dhe monedhave që shkojnë përmes BPK-së, por po ashtu edhe e ndarjes të valutave të falsifikuara dhe të dëmtuara. Pjesëmarrja e kartmonedhave të falsifikuara në depozitët e tërësishëm në para të gatshme të përpunuar dhe pranuar nga BPK-ja në 2003 ishte 0.0021%. Duke pasë parasysh këtë përqindje, mund të mendohet se kontrolli për zbulimin e kartmonedhave të falsifikuara mund të mos jetë i besueshëm, por fakti është se besueshmëria e këtij kontrolli vjen nga investimet e mëdha të BPK-së në një teknologji të lartë të përpunimit të parave ("De la Rue") dhe trajnimit të kuadrit. Arsyeimi plotësues në këtë besueshmëri të lartë vjen nga fakti se BPK-ja ka eksportuar në të gatshme rreth 188 milion euro (paraja e gatshme që vjen nga depozitët e bankave komerciale dhe kryesisht nga mbledhja e tatimeve), dhe importuar në para të gatshme rreth 21 milion euro, gjatë 2003. Të gjitha këto janë bërë pa asnjë ankesë nga bankat korresponduese.

BPK-ja po mban rezervat e parave të gatshme me qëllim që të furnizojë Kosovën jo vetëm në kushte normale (në përgjithësi, BPK-ja mund të ketë ndonjë urdhëresë për të dorëzuar para të gatshme brenda 24 orëve), por po ashtu në çfarëdo rasti tjetër të papritur që mund të ndodhë. Pasi që kjo paraqet një operacion mjaft kushtues, BPK-ja tashmë po e rishqyrton projektin e saj të përgjithshëm të sigurisë. Poashtu ekzistojnë shpenzimet lidhur me faktin se mjetet në thesarin e BPK-së në bilancin e gjendjes janë pa kamatë dhe kjo mund të klasifikohet si shpenzim i mundshëm e që zakonisht nuk krijohet nga bankat qendrore.

## Sistemi i pagesave – paraaja bankare

Në vendimin për të mbyllur rrjetën e saj të filialave në vitin 2002, BPK-ja përfundoi me aktivitetet e saj komerciale. Evoluimi në tranzicion i kryer nga BPK-ja nga aktivitetet komerciale (sektori jo-financiar) në aktivitetet tradicionale (sektori financiar) mund të shihet nga figura më poshtë:


**Grafiku 10. Zhvillimi i sistemit të pagesave – Ndërrimi sektoral**



Në 2003, BPK-ja ka vazhduar me përpjekjet e saj për të zhvilluar paratë bankare në Kosovë. Progresi i arritur në këtë drejtim mund të vlerësohet nga të dhënat që përshkruajnë zhvillimin e depozitëve me banka komerciale, dhe atë me operacionet e pagesave ndër-bankare.

Grafiku më poshtë tregon jo vetëm ndërrimin e konsiderueshëm nga valuta fiduciare në paratë bankare, por po ashtu përmirësim në strukturën e depozitëve dhe më shumë rritje të besimit në sektorin bankar.

**Grafiku 11. Zhvillimi i depozitëve në banka komerciale**



Më tutje në tranzicionin gradual të operacioneve bankare pa para të gatshme dhe në uljen e nevojës për para të gatshme, rëndësia e një Sistemi efikas të Pagesave Ndër-bankare u bë më tepër evidente.

BPK-ja jo vetëm që i menaxhon dhe monitoron operacionet por po ashtu merr pjesë drejtpërdrejtë në Sistemin e Pagesave Ndër-bankare (SPN), ku të gjitha, shtatë bankat komerciale janë pjesëmarrëse. Procedurat e pagesave dhe rregullimit janë definuar duke u bazuar në Rregullën e BPK-së Nr.XVIII dhe Regulloren e Pagesave të Transaksioneve Nr. 2001/26.


Katër banka komerciale përfshirë edhe vetë BPK-në kanë përmirësuar pjesëmarrjen e tyre në SPN përmes implementimit të lidhjes së automatizuar në mes të serverëve të tyre (sistemet e kontabilitetit) dhe serverit SPN gjatë vitit 2003.

Numri i transaksioneve që kaluan përmes sistemit të pagesave ndër-bankare është rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe dëshmon se besueshmëria e kosovarëve në industrinë bankare po kthehet.

SPN filloi me 4,888 transaksione (79,535,000 euro) në 2001 dhe 75,763 (840,605,000 euro) në 2002, ku më 2003 numri tërësisht i transaksioneve arriti në 164,207 (1,416,118,929.28 euro).

Më 2003, mesatarja e transaksioneve ndër-bankare arriti në 655 në muaj (vlera mesatare: 5,619,519 euro), dhe kjo është një rritje prej 128 % (në numër) apo 68 % (në vlerë), krahasuar me mesataren në 2002.

**Grafiku 12: Zhvillimi i operacioneve të SPN-së në 2003**



Provizionet e ngarkuara nga ICS-i, për anëtarësi dhe transaksione, mbetën të pandryshuara gjatë vitit. Përveç pagesave të rregullta (transferet bankë-bankë) dhe prioritare (numër i vogël i transfereve individuale), operacionet e SPN-së po ashtu përfshijnë pagesat masive. Pritet që moduli i pagesave masive të finalizohet dhe implementohet gjatë vitit 2004.

Përmes departamentit të saj të shërbimeve bankare, BPK-ja ka zhvilluar marrëdhënie të mira me të gjithë klientët e saj, veçanërisht me Departamentin e Thesarit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), me synim në drejtim të optimizimit të mëtejshëm të sistemit të pagesave. BPK-ja ka përmirësuar shërbimet e saj për klientët e tjerë (institucionet financiare dhe qeveritare) me të gjitha nevojat e tyre (përpunimi i urdhër pagesave, raporteve të llogarisë, hapja dhe mbyllja e llogarive etj.). Sa i përket këtyre aktiviteteve në 2003, BPK ka përpunuar 76,309 urdhëresa dalëse (pagesa në emër të klientëve të BPK-së) dhe 35,650 urdhëresa hyrëse (fondet e pranuar për klientët e BPK-së). E shprehur në vlerë, shuma e pagesave dalëse në 2003 arriti në 578 milion euro, ndërsa shuma e pagesave hyrëse ishte 686 milion euro.

Më tutje, me mbështetjen e FMN-së (në fund të vitit 2003), BPK-ja ka filluar me implementimin e një projekti të ri me qëllim që të zhvillojë lloje të reja të pagesave. Një ambient i mirë për një projekt të tillë tashmë ka filluar, duke iu falenderuar përpjekjeve të bankave komerciale. Prandaj, 35 Bankomata kanë filluar të funksionojnë dhe disa nga bankat komerciale kanë filluar me shërbime bankare elektronike, kartela bankare kreditimi (credit-card) dhe kartela ndërkombëtare kreditimi (Master Card).

Tashmë, BPK-ja është angazhuar të paraqesë urdhëresa të drejtpërdrejta debitore dhe urdhëresa të përhershme, me qëllim që të largojë njerëzit të shkojnë në banka komerciale për tërheqje të parave lidhur me pagesat e faturave të shërbimeve publike (KEK, PTK, etj.).


## Bankier për qeverinë

Bazuar në Regulloren e UNMIK-ut nr 1999/20, sipas nenit mbi Autoritetin e Posaqëm të BPK-së, BPK-së i është dhënë funksioni i **bankierit të qeverisë**.

Operacionet e fundit komerciale janë kryer nga BPK-ja në tre-mujorin e parë 2003 dhe nga ajo kohë BPK-ja ka vepruar kryesisht si bankier për qeverinë dhe për disa kompani publike që kanë ofruar shërbime publike.

Roli në rritje i BPK-së si autoritet bankar është mjaft i dukshëm duke pasë parasysh shifrat e kontabilitetit të BPK-së, ku depozitët në llogaritë e IPVQ-ve kanë një trend rritës, vit pas viti. Në fakt, këto kryesisht janë para të buxhetit (që kanë arritur shumën prej 348 milion euro, në 2003) dhe thjesht nuk mund të konsiderohen si tepricë e buxhetit, pasi që ka zotime të vazhdueshme buxhetare, dhe vlerësimet paraprake në tepricën e buxhetit për 2003 kanë arritur në 75 milion euro.


**Grafiku 13: Zhvillimi i depozitëve të qeverisë**



BPK-ja ka fuqinë e **menaxhimit të të gjitha mjeteve** sipas politikës rigoroze të themeluar në bazë të standardeve të FMN-së. Funksioni i Menaxhimit të Mjeteve Jashtë vendit është ri-fokusuar dhe racionalizuar gjatë vitit në linjë me udhëzimet e Politikës së re të Investimit të BPK-së që është aprovuar nga Këshilli Drejtues i BPK-së në maj 2003. Funksioni i Menaxhimit të Rrezikut është zhvilluar në Departamentin e Menaxhimit të Mjeteve për të bërë vlerësimin e të gjitha rreziqeve në lidhje me operacionet e investimit. Ky funksion është kryer në bazë të tri parimeve kryesore: siguria, likuiditeti, dhe fitimi (norma e kthimit) në investim.


Sipas aspektit të sigurisë të aktivitetit të menaxhimit të mjeteve, BPK-ja investon vetëm në bankat qëndrore të BE-së dhe në bankat komerciale duke respektuar gjatë tërë kohës shpërndarjen gjeografike të rrezikut (shih grafikun më poshtë). BPK-ja vazhdoj marrëdhëniet e saj të mira dhe gjatë të krijuara afariste me Deutsche Bundesbank në Frankfurt dhe në banka të tjera korrespondente në Gjermani dhe Austri. BPK-ja po ashtu ka zgjeruar marrëdhëniet afariste me katër banka komerciale të vlerësuara lartë në Suedi, Belgjikë dhe Holandë, në listën e saj të partnerëve për investime.

**Grafiku 14: Investimet e Huaja sipas shpërndarjes gjeografike**



Me qëllim të shmangjes së çfarëdo mos-përputhje të afateve, BPK-ja ka mirëmbajtur likuiditetin e fortë mbi investimet e saj. Siç shihet në grafikun më poshtë, gjysma e këtyre investimeve kanë afatin e skadimit brenda 14 ditësh.

**Grafiku 15: Investimet e huaja sipas afatit të skadimit**



Duke vëzhguar rregullat e përpikta të maturisë, duke mirëmbajtur sigurinë e investimeve dhe sigurimin e likuiditetit adekuat, BPK-ja po ashtu ishte në gjendje të përmirësojë normën e kthimit (fitimin) në investimet e saj. Në fakt, Menaxhimi i Mjeteve paraqet burimin kryesor të të ardhurave për BPK-në, dhe për 2003 ka arritur në 8 milion euro.

Numri i pagesave të jashtme në emër të Qeverisë Qëndrore dhe institucioneve financiare ishte relativisht i ulët në 2003, vlera e tyre e tërësishme megjithatë vazhdoi të jetë e konsiderueshme. Sigurimi i likuiditetit ditor të nevojshëm mbeti një nga detyrat kryesore të Departamentit të Menaxhimit të Mjeteve. Ndarja e detyrave në mes aktiviteteve operuese dhe raporteve vazhdoi të vëzhgohet në mënyrë të rreptë. Zyra Mbështetëse mbështet operacionet e Departamentit të Menaxhimit të Mjeteve duke siguruar informatë më të re mbi bilancet e të gjitha llogarive nostro, barazimin e lëvizjeve të parave të gatshme, regjistrimin e saktë të të gjitha transaksioneve dhe ekzekutimin e pagesave.

## Aktivite tjera të interesit të përgjithshëm

Për shkak të ekspertizës së saj të njohur, neutralitetit dhe pavarësisë, BPK-ja nuk është duke i siguruar vetëm shërbimet që zakonisht gjenden në bankat qëndrore, por po ashtu merr pjesë në ndërtimin e kapaciteteve të sektorit financiar në përgjithësi. Për shkak të kësaj, është kërkuar nga faktorët e sektorit financiar që BPK të udhëheqë **Zyrën Informative të Kredisë** brenda BPK-së, ku do të përfitonin kredidhënësit, konsumatorët dhe e tërë ekonomia si tërësi.

Për momentin, Sistemi i Informimit Kreditor të Kosovës shfrytëzohet nga një numër i kufizuar i bankave dhe institucioneve mikro-financiare. Bankat Komerciale kanë kërkuar që BPK-ja të themelojë dhe të operojë sistemin e raportimit kreditor, që është në proces.

Përveç kësaj, BPK-ja ka marrë rolin drejtues në themelimin e **Institutit të Trajnimit Bankar** për t'i përmbushur nevojat e bankave komerciale. Në të ardhmen e afërt, me përfundimin e projektit të financuar nga Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER) lidhur me Shoqatën e Bankierëve të Kosovës, ky institucion do të vendoset nën ombrellën e Shoqatës së Bankierëve të Kosovës.

BPK-ja ka qenë anëtare e Këshillit të Kosovës mbi Standardet për Raportimin Financiar (KBSFR) dhe është duke marrë pjesë në ngritjen profesionale të kontabilitetit, (kontabilistët e certifikuar dhe revizorët e jashtëm) në të njejtën kohë. Përveç kësaj, BPK-ja është planifikuar të jetë autoriteti i kontabilitetit për themelimin e standardeve të kontabilitetit dhe mbështesë revizorët e jashtëm në sektorin financiar (bankat komerciale, kompanitë e sigurimit dhe fondet pensionale).

## Këshilltar për marrësit e vendimit publik

Duke pasë parasysh Regulloren Nr.1999/20, ku në mesin e autorizimeve të rëndësishme specifike të BPK-së janë "rekomandimi i udhëzimeve të gjëra të politikave", "kryerja e analizave të rregullta ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës", dhe "publikimi i rezultateve", BPK-ja ka zhvilluar kapacitet të fortë të **Kërkimeve dhe Statistikës**. Në fazën e parë janë mbledhur të dhënat në sektorin financiar, janë përmirësuar të dhënat bazuar në standardet e FMN-së mbi statistikën monetare dhe financiare. Këto të dhëna rregullisht janë publikuar në Buletinin Mujor Statistikor (BMS), që është shpërndarë rregullisht në më shumë se 75 institucione të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, si dhe në faqen e internetit të BPK-së.

Sikurse në vitet e mëparshme, në 2003 FMN-ja ka vazhduar në ofrimin e ndihmës së konsiderueshme teknike për BPK-në. Përveç vizitave të rregullta të stafit të FMN-së dhe misioneve të vazhdueshme (promovimit të sistemeve të pagesës pa para të gatshme, mbikqyrjen në vend, çështjen e sigurisë), viti 2003 veçanërisht ishte i karakterizuar me caktimin e tre ekspertëve të misionit të FMN-së si asistencë teknike në Departamentin e Kërkimeve dhe Statistikës në BPK. Janë tri objektiva kryesore të këtyre misioneve: ngritja e funksionit të Kërkimeve në Departamentin e Kërkimeve dhe Statistikës (DKS), përmirësimi i mëtejme i statistikave monetare dhe financiare (gjashtë muaj të misionit peripatetik) dhe përpilimi i statistikave të bilancit të pagesave (dy vite të misionit multi-sektoral në ESK dhe BPK).

Në bazë të këtyre objektivave, dy hulumtues makroekonomik (me magjistraturë nga jashtë) janë punësuar dhe dy raporte të reja (Raporti i Statistikave Bankare dhe Raporti i Normave të Kamatës) janë përpiluar, kurse korniza e parë e statistikave të bilancit të pagesave do të fillojë më 2004.

Përveç trajnimit „të mësojmë duke bërë“ që vjen nga ndihma teknike e përmendur e FMN-së, stafi i DKS-së ka përfutur po ashtu nga kurset dhe seminarët e organizuara nga Institucioni i FMN-së dhe më tepër detaje mbi këtë janë specifikuar në pjesën mbi trajnimet.

## 2. BPK – Autoriteti Financiar i Kosovës

### Hyrje

BPK-ja ka pushtet rregullator dhe zbatues për të gjitha institucionet financiare në Kosovë dhe merr pjesë në zhvillimin dhe modernizimin e sektorit financiar, që tashmë përfshin industrinë bankare, industrinë e sigurimeve dhe fondet pensionale.

Qëllimi i BPK-së është që të ketë mbikqyrje financiare dhe proces rregullator që është efikas, fleksibil dhe që promovon sektorin financiar bazuar në konkurrencën e tregut, që i përmbush parimet më të mira të standardeve ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit financiar.

Qasja e mbikqyrjes e adaptuar nga BPK-ja është e bazuar në sistemin e bazuar në rreziqe. Kjo qasje synohet t'i mundësojë BPK-së që të shpërndajë në mënyrë të duhur resurset e saj mbikqyrëse në ato fusha të rrezikut më të madh, brenda çdo institucioni financiar dhe sektori financiar në përgjithësi. Mbikqyrja në bazë të rrezikut përqëndrohet në aftësinë e menaxhmentit për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rrezikun.

Në pajtim me legjislacionin që udhëheq funksionet e saj statutare (Regulloret e UNMIK-ut 1999/21 dhe 2001/24), BPK-ja ka parashtruar standardet e detajuara të mbikqyrjes dhe kërkesat me qëllim të rregullimit të **sektorit bankar**. Përveç kësaj, rregulloret i japin Këshillit Drejtues të BPK-së fuqinë për të adoptuar rregullat e mbikqyrjes së matur, që krijojnë limitet, udhëzimet operuese, procedurat dhe kërkesat raportuese për institucione financiare për banka dhe jo-banka. Korniza ligjore përfshin dispozitat dhe fuqitë për kërkesat e kapitalit, për të aprovuar ose refuzuar aplikacionet për licencë apo autorizim për të kryer inspektime në vendngjarje dhe zbatuar veprimet për mospërputhje me kërkesat ligjore apo praktikën jo të sigurta dhe jo të shëndosha bankare. Regulloret dhe rregullat e matura vazhdimisht janë duke u shqyrtuar dhe azhuruar që të vazhdojnë të jenë në linjë me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe të tentojnë bilancin e duhur në sigurimin e ambientit të rregulluar mirë duke mos imponuar ngarkesa të panevojshme për shfrytëzuesit e fundit të shërbimeve financiare.

**Ligji pensional** i përgjithshëm (Regullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë) është adaptuar në dhjetor 2001. Regullorja themeloi Departamentin e Mbikqyrjes Pensionale në BPK. Departamenti është i ngarkuar me funksionet rregullatore dhe mbikqyrëse mbi aktivitetet e biznesit të Pensionit Suplementar të Punëdhënësit (Fondet Pensionale) dhe ofruesit e Pensioneve Individuale Plotësuese.

Këto funksione po ashtu vlejné për ofruesit e shërbimeve të subjekteve pensionale, përfshirë Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), Menaxherët e mjeteve dhe kujdestarët e mjeteve pensionale. Departamenti i Mbikqyrjes Pensionale është themeluar dhe organizuar në qershor 2002.

### 2.1. Aktiviteti i BPK-së mbi Rregullimin e Sektorit Financiar

**Si rregullator, BPK-ja** merr pjesë në elaborimin e Regulloreve të UNMIK-ut. Një varg rregullash që paraqesin kornizën ligjore për qeverisjen e këtyre aktivitetëve, sipas standardeve të BE-së janë

adaptuar ndaj nivelit të tashëm të zhvillimit të institucioneve financiare në Kosovë. Kjo kornizë ligjore regullisht është përmirësuar ndaj evoluimit të ri të institucioneve financiare dhe është plotësuar nga rregullat dhe vendimet e BPK-së.

Regullat kryesore të miratuara në 2003 janë me sa vijojnë:

Një pjesë e rëndësishme e procesit të mbikqyrjes është autoriteti i mbikqyrësve bankar për të zhvilluar dhe shfrytëzuar rregulloret dhe kërkesat prudenciale për të kontrolluar rreziqet bankare. Me qëllim që të forcohet korniza regullatore dhe të **përmirësohet funksioni i mbikqyrjes bankare**, në vitin 2003, Këshilli Drejtues krijoi/plotësoi rregullat me sa vijojnë:

- Regulla XI e shtuar mbi Raportimin e Bankave dhe Filialave të Huaja për të kërkuar raporte mujore mbi importin dhe eksportin e parasë së gatshme.
- Regulla XVI e shtuar mbi Licencimin, Mbikqyrjen dhe Operacionet e Këmbimoreve dhe Shërbimet për Transferin e parave e të cilat operojnë në Kosovë, ku çdo aplikant për licencë duhet të ofrojë letër garantuese (surety, bond), garancion bankar, apo letër të pakthyeshme të kredisë në shumën prej € 100,000.
- Regulla e adaptuar XXIII mbi autoritetin bankar për Mbjajtjen e Pronës së Patundshme. Regulla citon se bankat mund të blejnë dhe mbajnë pasuri të patundshme vetëm po të jetë e nevojshme sigurimi i transaksionit të biznesit të saj, dhe pasuria e patundshme e fituar përmes sigurimit të borxheve e kontraktuar më herët. Sipas Regullës periudha e mbajtjes së lejueshme për pasurinë e patundshme e fituar përmes sigurimit të borxheve është tri vite.
- Regulla e adaptuar XXIV mbi Publikimin e Përmbledhjes së Bilancit Tremujor të Gjendjes. Regulla siguron udhëzimet për dhe standardizon publikimin e bilancit tremujor të gjendjes të bankave në mediat lokale dhe po ashtu në faqen e internetit të BPK-së.
- Regulla e adaptuar XXV mbi Themelimin, Rishpërndarjen dhe Mbylljen e Filialave. Regulla themelon udhëzimet dhe kërkesat për themelimin e filialave, rishpërndarjen e filialave dhe mbylljen e filialave.

Është me rëndësi për të theksuar një indikator të rëndësishëm se Regulla XXI mbi Rritjen e Kapitalit Minimal të bankave e adaptuar në dhjetor 2001 kërkoi që të gjitha bankat të rrisin kapitalin e tyre minimal deri në fund të vitit 2003 në 4 milion Euro. Të gjitha bankat me sukses plotësuan kërkesën.

Shtatë **Regulla** që qeverisin licencimin dhe operacionet e **kompanive të sigurimit jetësor** janë përpiluar në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë, që të rekomandohen për t'u aprovuar nga Këshilli Drejtues i BPK-së gjatë vitit 2004.

Është themeluar një kornizë e shëndoshë ligjore për licencimin dhe mbikqyrjen e planeve plotësuese pensionale dhe për mbikqyrje të kërkesave të TKPK-së për raportimin dhe kontributet e obligueshme të sigurimit pensional. Përveç Regulloreve Pensionale, në fund të dhjetorit 2003 njëzet e gjashtë Regulla mbi pensionet janë adaptuar dhe janë nxjerrë nga BPK-ja si legjislacion dytësor. Regullat qeverisin kërkesat e licencimit për plane pensionale shtesë, kërkesat për raportim të TKPK-së, mbikqyrjen e vazhdueshme dhe kërkesat e menaxhimit të investimeve të shoqëruara me sistemin e definuar kontribues të nivelit të dytë të themeluar sipas Regullorës Pensionale. Në nëntor 2003, një propozim Amandament mbi Regulloren Pensionale i është dorëzuar Këshilltarit Ligjor në UNMIK, që do të sigurojë zbatimin e vendimeve të Departamentit të Mbikqyrjes Pensionale të BPK-së lidhur me TKPK-në dhe skemat pensionale plotësuese.

Përveç kësaj, regullorja kundër shpërlarjes së parave e aprovuar në kohë të fundit nga UNMIK-u (Regullorja 2004/2 mbi Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Kundërvajtjet Kriminale përkatëse), e definon shpërlarjen e parave si aktivitet kriminal, që nuk ishte rasti me rregullat e mëparshme administrative (Regulla e BPK-së Nr. X), kur institucionet financiare duhej të deklaroinin mbi shumat e depozituara mbi 15,000 euro dhe transaksionet e dyshimta.

## 2.2. Aktiviteti Mbikqyrës dhe Zbatues

### 2.2.1. Licencimi dhe Struktura

Sipas Regullores 1999/21, BPK-ja ka autoritetin të vendosë kriteret për licencim bankar dhe për të refuzuar kërkesat mbi themelimin e bankave të reja, të cilat nuk i përmbushin standardet.

Strategjia e BPK-së në fushën e **licencimit bankar** është e përqëndruar në tërheqjen e investitorëve të cilët duke pasë pozitë të fortë financiare, menaxhment dhe aksionarë të duhur dhe të përshtatshëm, të jenë në gjendje të ndjekin një qasje të kujdesshme në punët bankare për të mbrojtur interesat e klientëve, duke i ndihmuar kështu përfundimit të sistemit bankar dhe rritjes së besueshmërisë në të.

**Bankat Komeriale.** Aktiviteti i Licencimit gjatë vitit 2003 në rradhë të parë ishte i lidhur me hapjen e filialave të reja të bankës dhe ndryshimet në strukturat e pronësisë bankare. Me kërkesën për rritje të kapitalit në minimum prej euro 4 milion deri më 31 dhjetor 2003, në vitin 2003 janë procesuar një numër i madh i kërkesave nga bankat lokale lidhur me ndryshimet në strukturën e pronësisë. Deri në fund të vitit 2003, të gjitha bankat në mënyrë të suksesshme përmbushën kërkesat për kapital të duhur.

Gjatë vitit 2003, BPK-ja revokoi aprovimin preliminar për licencë të filialës së huaj që ishte zgjatur në 2002. Që nga nxjerrja e Regullores së UNMIK-ut 1999/20 (e plotësuar nga Regullorja 2001/24) mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës në nëntor 1999, BPK-ja ka refuzuar 11 kërkesa për licencë bankare.

Numri i bankave gjatë vitit 2003 ka mbetur i njëjtë siç ka qenë në 2002 me 7 banka komerciale. Tridhjetë e katër (34) kërkesa për licencë të filialave janë përpunuar nga Departamenti i Mbikqyrjes Bankare gjatë vitit. Përveç kësaj, kërkesat për tri (3) mbyllje të filialave janë përpunuar gjatë vitit. Në fund të vitit 2003, kanë operuar 7 banka me 148 filiala dhe ekspozitura në tërë Kosovën.

Më 7 Maj 2003, aksionet e mbetura të Bankës Amerikane të Kosovës janë shitur në Vienë në Raiffeisen International Bank-Holding AG, institucion qëndror i grupit të Raiffeisen Bankës (që në 2002 kanë blerë 75% të aksioneve) dhe nga ajo periudhë struktura e pronësisë ka ndryshuar dhe Grupi Bankar i Raiffeisen Bank-ës u bë aksionar i vetëm me 100% të aksioneve.

**Këmbimoret dhe Zyret e Transferit të Mjeteve.** Në vitin 2003 është aprovuar një (1) licencë për këmbimore, duke arritur totalin e katër (4) këmbimoreve të licencuara nga BPK-ja. Në fund të vitit 2003, kanë operuar dy (2) zyra të transferit të parave. Një zyrë e transferit të parave ndërpreu operacionet në 2003 dhe licenca e saj është revokuar.

**Institucionet Mikro Financiare.** Gjatë vitit 2003 BPK-ja ka regjistruar dy (2) institucione jo-bankare mikro financiare, dhe janë aprovuar gjashtë (6) asociacione kreditore që i takojnë një institucioni të caktuar mikro financiar. Në fund të vitit 2003, 18 institucione mikro-financiare kanë operuar në Kosovë.

Në bazë të autoritetit të dhënë nga Regullorja 2001/25 mbi Licencimin, Mbikqyrjen dhe Regullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit, aktiviteti i licencimit të sigurimit të BPK-së në 2003 ishte siç paraqitet në tabelën më poshtë:

**Tabela 8: Aktiviteti i Licencimit të Sigurimit në 2003**

Përshkrimi	2002	Aktivitetet e Licencimit në 2003			
		Kërkesat	Të Licencuara	Në proces	Të refuzuara
Kompanitë e Sigurimit	8	1	1	1	1
Kompanitë e Sigurimit Jetësor	0	2	0	2	0
Brokerët e Linjave Shtesë	0	1	1	0	0
Agjentët e Licencuar	339	126	154	64	53
Trajtuesit e Dëmeve	0	35	30	4	1
Trajtuesit e Pavarur të Ankesave	0	2	1	1	0
Sigurimi Vullnetar	4	12	10	2	0

Asnjë fond **Pensional Suplementar i Punëdhënësit** nuk është licencuar nga BPK-ja në vitin 2003; prandaj numri i planeve pensionale të licencuara mbetet në gjashtë, i njëjti numër që ka ekzistuar në fund të vitit 2002.

## 2.2.2. Kontrollimet Financiare

Për të kryer përgjegjësitë për licencimin dhe mbikqyrjen e të gjitha institucioneve financiare, Departamenti i Mbikqyrjes së BPK-së (Mbikqyrja Bankare, Mbikqyrja e Sigurimit dhe Regullimi i Fondeve Pensionale) bën mikqyrje të vazhdueshme përmes inspektimeve në dhe jashtë bankës.

Gjatë vitit 2003, është përpiluar Doracaku i Mbikqyrjes Pensionale, që përmban udhëzime për ekzaminuesit pensional gjatë aktiviteteve të inspektimit në vend dhe jashtë vendit. Doracaku përfshin detajet e procedurave të inspektimit dhe pyetësorët e kontrollit të brendshëm që kanë të bëjnë me kërkesat rregullore; qeverisjen e fondeve pensionale; kontributet e fondit pensional; investimet; qëndrueshmërinë financiare të fondit pensional; vlerësimin e kontroleve të brendshme; parimet e kontabilitetit; dhe parimet aktuariale të pensionit.

### Inspektimet në vendngjarje (on-site)

Puna e inspektimit në vendngjarje e kryer nga kontrollorët është strukturuar ashtu që siguron verifikimin e pavarur se ekziston kontrolli adekuat dhe se informata e siguruar nga institucionet financiare është e besueshme. Inspektimet në vendngjarje kryhen në pajtim me planin e inspektimit vjetor, që është rregulluar sipas nevojës për shkak të rrethanave të paparashikuara. Procedurat e standardizuara të mbikqyrjes në vend janë zhvilluar, dhe sa i përket sistemit bankar ato janë bazuar në sistemin CAMEL – shkalla e pestë për caktimin e rangut të bankave.

Gjatë vitit 2003 është kryer kontrolli i plotë në vendngjarje në secilën nga shtatë **bankat**. Përveç kësaj, 10 inspektime të kufizuara (të synuara) janë kryer gjatë vitit, që u përqendruan në çështjet specifike të mbikqyrjes. Inspektimet e synuara të kryera gjatë vitit 2003 në rradhë të parë u fokusuan në fushat me sa vijojnë: (1) Rreziku kreditor; (2) kreditimi për mbitërheqe; (3) Ndryshimet të aksionarët dhe strukturën e kapitalit të bankave; dhe (4) rreziqet operative.

Kërkesat për hapje të filialave dhe ekspoziturave të reja janë përcjellur me 37 kontrole plotësuese të para-hapjes.

Përveç kësaj, njëmbëdhjetë (11) kontrole në vendngjarje në institucionet financiare jo-bankare janë kryer gjatë vitit.

**Tabela 9. Sektori Financiar: Kontrollimet në vendngjarje të kryera gjatë vitit 2003**

Lloji i kontrollit		Numri i kontrollimeve
Industria Bankare	1. I plotë – bankat	7
	2. Kontrolli i Kufizuar – bankat	10
	3. Kontrolli i Para-hapjes – filialat	37
	4. Kontrollet e IMF-së	11
	5. Transferuesit e të Hollave	1
Industria Sigurimit	1. Kompanitë e Sigurimit	6
	2. Kompanitë e Sigurimit-filialat	4
	3. Kompanitë e Sigurimit – zyret e agjentëve	125

Gjatë vitit 2003, Departamenti i Mbikqyrjes **Pensionale** ka kryer një numër të madh të inspektimeve në fondet pensionale vullnetare në vendngjarje dhe jashtë vendit të ngjarjes. Inspektimet në vendngjarje u fokusuan në qeverisjen e fondeve pensionale, saktësinë e kontributeteve, mbajtjen e regjistrit, investimet e fondit pensional dhe kontrollat e brendshme.

### Kontrollimet jashtë vendngjarjes (off -site)

Procesi për identifikimin dhe monitorimin e problemeve potenciale në banka është zhvilluar veçanërisht në intervalin në mes të inspektimeve në vendngjarje. **Mbikqyrja dhe analiza e bankave** jashtë vendit të ngjarjes (off-site) përfshin me sa vijon: (1) analizën e vazhdueshme mujore të secilës bankë bazuar në raportet rregullatore të standardizuara bankare; dhe (2) analizën e përgjithshme të sektorit bankar për të zbuluar rrezikun sistemor. Gjatë vitit 2003, Departamenti i Mbikqyrjes Bankare ka kryer 28 analiza jashtë vendngjarjes në 7 banka komerciale.

Kontrollimet e brendshme paraqesin një formë të vazhdueshme të procesit të monitorimit dhe mbikqyrjes së aktiviteteve të **kompanive të sigurimit**. Përmes kontrollimeve të tilla, informata është mbledhë mbi kompanitë e sigurimit, aktivitetet e tyre dhe nivelin e përputhjes me rregulla të sigurimit. Kompanitë e sigurimit kërkohen të dorëzojnë të dhënat statistikore dhe financiare në BPK rregullisht. Një raportim i tillë përfshin të dhënat mujore dhe tremujore mbi premitë, shpenzimet, investimet, rrjedhjen e parave të gatshme dhe dëmet. Bazuar në këto raporte, Departamenti i Sigurimit përpilon raportet mujore të përgjithshme të statistikës mbi sigurimet, që përfshijnë zhvillimet kryesore në industrinë e sigurimit.

Revizionet jashtë vendngjarjes (off-site) të kryera në 2003 u përqëndruan në qëndrueshmërinë financiare të **fondeve pensionale**, kualifikimet e pjesëmarrësve të ri dhe barazimin e kontributeve dhe pagesave pensionale.

### 2.2.3. Autoriteti Formal i Mbikqyrësve (Veprimet e Zbatimit)

**Bankat Komerciale.** Përveç përpjekjeve të mbikqyrësve, ka pasur raste kur bankat kanë dështuar t'i përmbushin kërkesat e matura mbikqyrëse apo kanë shfrytëzuar praktika jo të sigurta dhe jo të shëndosha. Si rezultat i shkëlqeve të rregullave apo praktikës jo të sigurtë dhe jo të shëndoshë bankare, BPK-ja inicioi 11 veprime zbatuese kundër bankave më 2003. Veprimet për zbatim të detyrueshëm përfshinë paralajmërimet me shkrim, urdhëra administrative që vlerësojnë ndëshkimet monetare (kundër institucioneve dhe individëve), dhe marrëveshje formale që kërkojnë

rritje të kapitalit dhe kufizime të aktiviteteve të caktuara. Shembujt e shkeljeve dhe devijimeve të rregullave nga praktika e shëndoshë bankare, e që rezultoi në ndëshkimet administrative, përfshinë: 1) Shkeljet e Regullës II në shumën maksimale të kredisë së lejuar një huamarrësi apo huamarrësit përkatës; (2) Shkeljen e Regullës VII mbi limitet e këmbimoreve për neto pozicionet e hapura; (3) Shkeljet e Regullës IX mbi kërkesat e raportimit. Gjatë vitit 2003 është vlerësuar se një shumë prej gjithsej euro 54,000 është kredituar në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës si gjobë ndaj bankave.

**Kompanitë e Sigurimit.** Gjatë kontrolleve të kompanive të sigurimit të kryera në 2003 janë gjetur shkelje të rregullave të sigurimit, që rezultuan në paralajmërimin me shkrim dhe ndëshkimet monetare. Masat disiplinore që janë ndërmarrë kundër kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit në 2003 janë me sa vijojnë:

- 12 urdhëresa kundër kompanive të sigurimit,
- 2 urdhëresa kundër aksionarëve,
- 9 urdhëresa kundër menaxherëve të filialave, dhe
- 8 urdhëresa kundër agjentëve.

Shuma e tërësishme e të hyrave që shkojnë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, të marra nga këto masa disiplinore gjatë vitit 2003 janë 120,250 euro.

Si rezultat i shkeljeve serioze të rregullave dhe rregulloreve të sigurimit, BPK-ja caktoi administratorin e përkohshëm në tetor 2003 për të marrë kontrollin e Kompanisë së Sigurimit Drini 2000. Si rrjedhim, licenca e kompanisë ishte revokuar nga BPK-ja dhe Kompania e Sigurimit Sigal nga Shqipëria, e cila ishte licencuar më 23 tetor 2003 për të operuar në Kosovë, ka marrë udhëheqjen e saj.

Kontrolli dhe procesi i likuidimit për Kompaninë e Sigurimit Kosova, që filloi në prill 2002 ka vazhduar gjatë vitit 2003 dhe tani është në fazën përfundimtare. Përmes tenderit dhe ankandit publik, pranuesi shiti pasurinë e patundshme që zotërohej nga kompania në dhjetor 2003.

### 2.3. Bashkëpunimi Ndërkombëtar

**Mbikqyrja bankare ndër-kufitare.** Në pajtim me Parimet Themelore të Bazelit për Mbikqyrje Bankare Efektive, qëllimi i BPK-së është të praktikojë mbikqyrjen bankare globale të konsoliduar. Një komponentë kyçe e mbikqyrjes së konsoliduar është themelimi i kontakteve dhe shkëmbimi i informatave me autoritetet tjera mbikqyrëse. Një Marrëveshje e Mirëkuptimit (MEM) mbi mbikqyrjen bankare ndër-kufitare dhe shkëmbim të informatave është nënshkruar në mes të BPK-së dhe Bankës së Shqipërisë më 2002. Në fund të 2003, filluan diskutimet me Bankën Kombëtare të Serbisë mbi themelimin e një MEM mbi bashkëpunimin reciprok të çështjeve të mbikqyrjes bankare dhe shkëmbim informatash.

**Memorandumet e Mirëkuptimit të Sigurimit Ndërkombëtar.** Paralelisht me strukturat tjera të UNMIK-ut, BPK-ja ka punuar shumë për të përmirësuar lirinë e lëvizjes për qytetarët e Kosovës me qëllim të udhëtimit në vendet fqinje. Kosova nuk është pjesë e sistemit të Green Card-ës ndërkombëtare; prandaj, MEM-të janë negociuar me vendet tjera për trafik të hapur të automjeteve dhe për njohje reciproke të sigurimit TPL. Gjatë vitit 2003, MEM-të janë nënshkruar me Shqipërinë, IRJM dhe Kroacinë. Po ashtu negociatat me Bullgarinë dhe Turqinë mbi njohjen reciproke të sigurimit TPL janë në fazën përfundimtare.

Pesë kompani të sigurimit nga jurisdiksonet tjera janë licencuar nga BPK-ja për të operuar në Kosovë. Me qëllim të formalizimit të bashkëpunimit me autoritetet fqinje mbikqyrëse të sigurimit, në vitin 2003 me autoritetin mbikqyrës të sigurimit të Shqipërisë është përgatitur një MEM mbi bashkëpunimin reciprok të çështjeve të mbikqyrjes ndër-kufitare.

### 2.4. Zhvillimet Kryesore të Sektorit Financiar

**Zhvillimet në Industrinë Bankare.** Zhvillimi i industrisë bankare vazhdoi gjatë tërë vitit 2003. Derisa numri i bankave mbeti i njejtë sikurse vitin e kaluar, shumica e bankave vazhduan të bëjnë përpjekje të mëdha të zgjerojnë rretjen e tyre në tërë Kosovën. Siç është përmendur më parë numri i degëve të tyre në fund të vitit 2003 arriti në 148 duke lehtësuar qasjen në shërbimet bankare për qytetarët dhe ndërmarrjet në Kosovë.

Më 31 dhjetorit 2003, mjetet e tërësishme të grumbulluara në sistemin bankar ishin 581,5 milion euro krahasuar me 471 milion euro nga viti i mëparshëm, apo 110,5 milion euro më shumë. Rritja e kredisë ishte veçanërisht e lartë gjatë vitit 2003 me një shumë të kredive të papaguara për sektorin bankar duke u rritur me nga 146,2 milion euro në 232,7 milion euro, një rritje prej 169%. Në të njejtën kohë, depozitët e tërësishëm në sistemin bankar në fund të vitit 2003 janë rritur për 93,8 milion euro apo 22,4% krahasuar me fillimin e vitit. Depozitët kanë arritur nivelin e tyre më të lartë që nga rithemelimi i sistemit bankar në vitin 2000, që reflekton një rritje në besueshmërinë publike ndaj sistemit bankar në Kosovë.

Në tërësi, sistemi bankar është mirë i kapitalizuar. BPK-ja ka rritur kërkesat minimale të kapitalit për banka në 2002 dhe përsëri në 2003, për t'i sjellur standardet e kapitalit në linjë me direktivat e BE-së. Siç është përmendur më herët të gjitha bankat kanë rritur kapitalin e tyre me sukses në apo mbi minimumin e kërkuar prej 4 milion euro deri në fund të vitit 2003. Bazuar në standardet e Bazelit mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, kapitali i tërësishëm për sistemin bankar më 31 dhjetor 2003 ishte i barabartë me 17% të mjeteve sipas kategorive të rrezikut.

Ish Banka Amerikane e Kosovës (tani Raiffeisen Banka e Kosovës) ka shitur aksionet e saj në Raiffesien International Bank-Holding AG dhe tani zotërohet 100% nga kompania Austriake. Ish MEB banka (Micro Enterprise Bank) ka ndryshuar emrin e saj në ProCredit Bank gjatë vitit pa asnjë pasojë negative lidhur me aktivitetet bankare.

Struktura e pronësisë së sektorit bankar më 31 dhjetor 2003 e matur nga pjesmarrja në kapital ishte 61% të kapitalit të huaj dhe 39% të kapitalit vendor. Nuk ka pronë shtetërore të bankave në Kosovë dhe një përqindje shumë e vogël e pjesmarrjes në kapital në sistemin bankar mbahet nga ndërmarrjet me pronësi shoqërore.

Zhvillimet tjera në sistemin bankar gjatë vitit 2003 përfshinë paraqitjen e Bankomatëve nga Raiffeisen Bank e Kosovës. Në fund të vitit, dy banka operonin me 35 Bankomatë. Përveç kësaj, ProCredit Bank instaloi një numër të terminaleve të pikave të shitjes gjatë vitit 2003.

Produktet e reja të kredisë të paraqitura nga dy banka gjatë vitit përfshinë kreditë për biznese për periudha më të gjata; dhe kredi për konsumatorë për blerjen e automobilave, renovim të shtëpive dhe mallra shtëpiake.

Tri banka tashmë kanë marrëveshje të huadhënies me KfW për një periudhe më të gjatë të kohës (3-5 vjet), që siguron një burim të fondeve për kredi afatgjata.

**Zhvillimet në industrinë e sigurimit.** Në vitin 2003, në Kosovë operonin 8 kompani të licencuara të sigurimit. Tri nga kompanitë janë inkuorporuar në Kosovë, ndërsa pesë kompani operojnë si filiala të kompanive të sigurimit të licencuara sipas ndonjë juridiksioni tjetër (3 nga Shqipëria dhe 2 nga Serbia). Po ashtu, në fund të vitit 2003, dy ndërmjetësues të licencuar të sigurimit operonin në Kosovë, një broker i linjave shtesë për sigurimin shëndetësor për të udhëtuar jashtë dhe një organizatë për rregullimin e kërkesave ndërkombëtare.

Premitë dhe rregullimet e kërkesave. Në vitin 2003, tetë kompani të sigurimit kanë pasur numrin e tërësishëm prej 214,623 polisave, një rritje prej 22% nga viti 2002. Të hyrat e tërësishme të premisë në 2003 ishin 34.4 milion euro, që ishte 10% më e lartë se në vitin 2002. Gjatë vitit 2003, më se 8,582 kërkesa të paguara kanë arritur shumën prej 6 milion euro, apo 70% më shumë se në 2002.

Një Fond Garantues është themeluar në bashkëpunim me Regullën 3, Neni 4. Fondi është krijuar nga kontributet e paguara nga kompanitë e sigurimit për sigurimin TPL. Fondi Garantues drejtohet nga Këshilli Drejtues, i përbërë nga një përfaqësues i çdo kompanie të sigurimit, që ofron sigurim të detyrueshëm dhe po ashtu nga ekspertët e dëmeve të caktuar nga Këshilli Drejtues. Emërtimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues duhet të ketë aprovimin paraprak të BPK-së.

Fitimet Bruto në Fondin Garantues gjatë vitit 2003 arritën në 1 milion euro, që paraqet një rritje prej 94%, krahasuar me 2002.

**Zhvillimi i Fondeve Pensionale.** Në fund të dhjetorit 2003, gjashtë plane pensionale të licencuara kishin shumën e kombinuar prej 3,521 pjesëmarrësve. Është pritur që më tepër ndërmarrje të themelojnë Fondet Pensionale për punëtorët e tyre si plotësim për pensionet mandatore të kursimeve individuale.

Një këshilltar në USAID shërbeu si ushtrues i detyrës së shefit të Departamentit të Mbikqyrjes Pensionale deri në emërimin e menaxherit vendor në mars 2003. Kontrollorët pensional kanë ndjekur trajnime ekstensive nga këshilltari ndërkombëtar lidhur me kornizën ligjore dhe regullatore të pensioneve si dhe aftësitë, teknikat dhe metodologjitë që aplikohen në funksionet mbikqyrëse të matura të pensioneve.

### III. Përmbledhje të Aktiviteteve të Brendshme të BPK-së


#### Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

Më 1 mars 2003 ishte implementuar eliminimi i të gjitha aktiviteteve komerciale në shërbimet bankare dhe emërimet e kosovarëve në pozitat kyçe menaxheriale, hapi i parë në procesin e kosovarizimit. Hapi i parë në drejtim të kosovarizimit të BPK-së ishte që ta bëjmë stafin lokal plotësisht të përgjegjshëm dhe të besueshëm për departamentet në të cilat ata janë të ngarkuar. Ish menaxherët ndërkombëtarë morrën rolin e këshilltarëve për udhëheqësit vendor të Departamenteve.

Numri mesatar i punëtorëve në muaj në vitin 2003 ishte 123, që rezulton në 381,420 ditë pune.

Përqindja e pushimit mjeksor në numrin e tërësishëm të ditëve të punës në 2003 ishte 0.05%, ndërsa përqindja e pushimit vjetor në numrin e tërësishëm të ditëve të punës ishte 0.23%.

Në 2003, përqindja e punëtorëve me diplomë univerzitare në numrin total të punëtorëve të BPK-së ishte 46.46 %.



#### Politika e Trajnimit të BPK-së

##### Grafiku 16. Lëvizjet e kuadrit në 2003

BPK-ja vlerëson se resursi i saj më i rëndësishëm është kuadri. BPK-ja është plotësisht e angazhuar për të siguruar se të gjithë anëtarët e kuadrit kanë njohuri të duhur, aftësi dhe ekspertizë për t'i kryer detyrat e tyre në përputhje me standardet e larta dhe arritjen e potencialit të plotë të tyre.

Për të arritur dhe zhvilluar këtë, BPK-ja ka zhvilluar një politikë të trajnimit me qëllim të përputhjes së nevojave dhe vendosjes së standardeve për trajnim profesional dhe zhvillim të punëtorëve të saj. Trajnimi i synuar është i strukturuar për një kohë të gjatë dhe shërben si ndërtim i kapacitetit. Këto procese do të udhëheqin BPK-në dhe stafin e saj për të fituar standardet më të larta të aftësisë, duke filluar me trajnimin bazë në procesimin e word-it, aplikacionet në tabela, parimet në kontabilitet dhe gjuhë angleze. Objektivi afatshkurtë i kësaj politike është se kuadri që kërkon këto aftësi do t'i posedojë brenda afatit më të shkurtër.

Politika parashtron udhëzimet për pjesmarrje në trajnim dhe kriteret e pranimit. Posa që kuadri të pranohet, ai duhet t'i përmbahet rregullave për çdo trajnim siç është përcjellja dhe raportimi në BPK (të tregohet njohuria e fituar). Politika siguron po ashtu angazhimet nga ana e kuadrit për të mbetur me BPK-në me qëllim të kthimit të garantuar të investimeve për BPK-në.

Gjatë vitit 2003, 27 anëtarë të kuadrit morrën pjesë në sesionet e trajnimit jashtë vendit duke absorbuar 594 ditë pune ndërsa 28 anëtarë të kuadrit morrën pjesë në sesionet e trajnimit vendor.

Janë ofruar rreth 250 orë të kursit të gjuhës angleze dhe 65 orë të trajnimit themelor kompjuterik në BPK dhe në trajnime të brendshme.

Kuadri i DKS-së ka përfutur po ashtu nga kurset dhe seminarët e organizuara nga Instituti i FMN-së. Prandaj, më 2003 anëtarët e stafit nga DKS-ja morrën pjesë në FMN JVI në Vienë në kursin mbi "Statistikat Monetare dhe Financiare" dhe në atë mbi "Statistikat e Bilancit të Pagesave", ndërsa një tjetër morri pjesë në "Statistikat Financiare të Qeverisë" seminar i organizuar së bashku me FMN-në dhe "Center for Excellence in Finance" në Lubllanë. Përveç kësaj, Shefi i DKS-së morri pjesë në kursin mbi "Programimin dhe Politikën Financiare", të organizuar nga Qendra e FMN-së.

Qëllimi i BPK-së vazhdon me trajnimin e kuadrit të mbikqyrësve bankar. Profili i trajnimit dhe zhvillimit është zbatuar për çdo mbikqyrës bankar. Iniciativat e trajnimit formal gjatë vitit 2003 kanë përfshirë me sa vijon: tre (3) inspektorë morrën pjesë në trajnimin me Bankën e Shqipërisë në Tiranë mbi Kontrollin e Brendshëm Bankar dhe kontrollimin në vendngjarje; dy (2) inspektorë morrën pjesë në seminarin mbi "Paratë, Punët bankare dhe Tregjet Financiare" të prezentuara nga ekspertët ndërkombëtarë në Univerzitetin e Prishtinës; dhe dy (2) inspektorë janë duke marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar të Kosovës.

Përveç kësaj, Drejtori i Mbikqyrjes Bankare morri pjesë në dy (2) seminare ndërkombëtare jashtë Kosovës me sa vijon: "Mbikqyrja Bankare sipas Bazel II Accord" e organizuar nga Deutsche Bundesbank në Frankfurt, dhe "Sistemet e Sigurimit të Depozitave në Ballkanin Perëndimor" organizuar nga IADI/BERZH në Bazel, Zvicër.

Katër inspektorë të sigurimit kanë marrë pjesë në trajnimet profesionale jashtë vendit, kurse gjashtë inspektorë kanë marrë pjesë në trajnimet profesionale të organizuara në Kosovë.

Gjatë tremujorit të katërt të 2003, Udhëheqësi i Departamentit të Mbikqyrjes Bankare organizoi dy programe trajnimi për inspektorët e ri me sa vijon: (1) Mbikqyrja Bankare Bazë, dhe (2) Hyrje në Analiza të Kredisë.

BPK-ja po ashtu e bëri të mundur për kuadrin e saj të ndjekë një program të gjerë të trajnimeve. Një anëtar i kuadrit të Teknologjisë Informative shkoi në Kanadë për të marrë certifikatën si Injiner i Certifikuar i MicroSoftit, që është i pari në Kosovë. Janë edhe dy anëtarë të kuadrit që po ndjekin programet e MBA-së jashtë vendit. Një anëtar i kuadrit më të lartë ka marrë pjesë në programin e trajnimit intenziv të FMN-së në Washington. Kurset e bankës për gjuhë angleze dhe IT po u ofrohen anëtarëve të kuadrit. Disa anëtarë të kuadrit janë duke ndjekur kurset vendore në kontabilitet nën mbikqyrje të Shoqatës së Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës (ShKAÇK).

## Zbatimi i aplikacionit Flexcube

Në fushën e teknologjisë BPK-ja ka bërë një hap të madh përpara me implementimin e sistemit të ri bankar global, Flexcube-it, i adaptuar në bazë të nevojave specifike të BPK-së. Një këshilltar ndërkombëtar është sjellur për të ndihmuar dhe menaxhuar projektin. Është bërë një avancim duke shfrytëzuar Oracle-in si sistem i bazës së të dhënave. Baza e re e të dhënave Oracle zëvendëson sistemin paraprak që ishte i bazuar në bazën e të dhënave të Access-it.

Sistemi i ri ofron grupin standard të raporteve bankare me më tepër informata duke lejuar një vendimmarrje dhe monitorim më të mirë të operacioneve. Për implementimin e këtij sistemi shitësi i siguroi BPK-së 2 konsultantë gjatë tërë procesit. Implementimi aktual filloi në janar 2003 pas 6 muajsh të periudhës së prokurimit dhe definimit të kërkesave për sistemin e ri bankar. Faza e zbatimit ishte e monitoruar për së afërmi me raporte dhe mbledhje të progresit javor. Sesioni i trajnimit tre-javor për shfrytëzuesit kryesor të të gjitha Departamenteve të sistemit të ri ishte pika filluese për këtë fazë duke treguar qka do të jetë në gjendje të bëjë sistemi në konfigurimin e tij në BPK dhe si do të funksionoj. Pas ndryshimeve të bëra të pasuara nga vërejtjet e bëra në sesionet e trajnimit filloi faza e testimit në datë fillestare duke redukuar punën jashtë orarit. Bazuar në rezultatet e kënaqshme, për një muaj të plotë është bërë një paralele duke krahasuar të dhënat e sistemit të ri me sistemin e vjetër.

Bazuar në këto rezultate, është caktuar që 1 qershor 2003 të jetë datë e fillimit të punës së këtij sistemi. Konsultantët qëndruan për 10 ditë më shumë si ndihmë plotësuese. Një tipar plotësues i sistemit ishte se ekziston parimi i krijuesit/kontrolluesit ('maker/checker'). Kjo nënkupton se çdo hyrje në sistem do të procesohet vetëm pas verifikimit dhe aprovimit të mbikqyrësit.

Përveç kësaj, BPK-ja kishte politikën e aprovuar të Teknologjisë Informative me "parimin një tavolinë një kompjuter" dhe regullat e përpikta për shfrytëzimin e rrjetit në BPK. Kjo politikë cakton regullat dhe obligimet për shfrytëzuesit e kompjuterëve në BPK. Këshilltari ndërkombëtar për Departamentin e Teknologjisë Informative u largua më 30 qershor 2003 dhe nga ajo datë departamenti udhëhiqet vetëm nga stafi vendor.

Departamenti i Kontabilitetit ishte ristrukturuar me implementimin e politikës së aplikacionit të ri bankar. Raportimi është edhe më tepër i thjeshtuar, i saktë dhe përmbush standardet e raportimit ndërkombëtar. Raportimi është më i saktë dhe i besueshëm se sa më parë. Për procesimin e të dhënave parimi krijuesi/kontrolluesi është prezentuar, kombinuar me përgjegjësi për çdo anëtar të kuadrit.

E aprovuar në kohë të fundit, Politika & Kodi i Etikës ka definuar përgjegjësitë reciproke në mes të punëmarrësit dhe punëdhënësit. Që nga fillimi i vitit 2003 anëtarët e kuadrit të BPK-së gëzojnë të drejtën për mbrojtje shëndetësore private dhe u ofrojnë punëtorëve të tyre pension suplementar me anë të Fondit Pensional të BPK-së. Janë 6 ish anëtarë të kuadrit që tashmë përfitojnë nga ky Fond Pensional i BPK-së (2 të pensionuar dhe 4 me pensionim të parakohshëm).

BPK-ja ishte institucioni i parë që ka përmbushur afatet e caktuara në rregulloret e ndryshme për dorëzimin e llogarive vjetore të audituara dhe raportin vjetor para përfundimit të afatit të fundit të caktuar në fund të muajit të katërt të vitit.

### **Faqja e internetit dhe buletini informativ i BPK-së**

Duke filluar nga 1 qershor 2003, faqja e internetit e BPK-së (<http://www.bpk-kos.org>) është instaluar, tërësisht e dizajnuar dhe e fuqizuar nga kuadrit i BPK-së. Deri më tani, faqja e internetit e BPK-së është vizituar nga më tepër se 17,000 individë.

Duke filluar nga 1 shkurti 2003, BPK-ja ka startuar me buletin informativ mujor të rregullt (newsletter) që redaktohet dhe publikohet nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun.

IV. Pasqyrat Financiare të  
Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës

## NJOHURI TË PËRGJITHSHME

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK) është subjekt i veçantë publik me të drejtë të liçencojë, mbikqyrë dhe rregulloj institucionet financiare në territorin e Kosovës. BPK është themeluar në pajtim me dispozitat e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut)- Rregulloren nr. 1999/20 të datës 15 nëntor 1999 (e përmirësuar më 1 tetor 2001 me rregulloren 2001/24) "Mbi Autoritetin Bankar të Pagesave të Kosovës".

Sipas kësaj Rregullore, objektivat kryesore të BPK-së janë:

- të nxitë një sistem efikas dhe të sigurt për pagesat e brendshme, dhe
- të nxitë likuiditetin, aftësinë paguese dhe funksionimin efikas të një sistemi financiarë të bazuar në një treg stabil, duke përfshirë rregullimin e bankave, kompanive të sigurimit dhe institucionet e tjera financiare

BPK-ja ka këto kompetenca të veçanta:

- T'i rekomandojë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm këshilla të përgjithshme të politikës së punës në fushat e përgjithësisë së saj, nën udhëheqjen e zëvendësit të Përfaqësuesit Special për Rindërtim dhe Zhvillim Ekonomik;
- Të formuloj dhe zbatoj masat për rregullimin dhe mbikqyrjen e pagesave dhe sistemeve për rregullimin e transaksioneve në valutë të vendit dhe të huaj në Kosovë;
- Të ketë dhe të zbatojë një ose më shumë sisteme të pagesave;
- Të veprojnë si bankier për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe me kërkesën e saj, t'i jep këshilla financiare;
- Të veprojnë si agjent fiskal i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
- Të mbaj depozita në valutë të huaj të bankave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe të subjekteve të tjera;
- Të sigurojnë para të mjaftueshme në banknota dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme;
- Të sigurojnë një vend për ruajtjen e sigurt të parave dhe letrave me vlerë;
- T'i liçencojë, mbikqyrë dhe rregulloj institucionet financiare;
- T'i mbikqyrë dhe rregulloj tregtarët e këmbimit të valutave të huaja; dhe
- Të kryej analiza të rregullta monetare dhe ekonomike të ekonomisë së Kosovës, t'i publikoj rezultatet dhe në bazë të atyre analizave t'i paraqesë propozimet dhe masat Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

BPK-ja funksionon përmes zyrës së saj qendrore të vendosur në Prishtinë.

## KËSHILLI DREJTUES

Këshilli drejtues harton politikën e veprimtarisë së Autoritetit Bankar dhe Pagesave të Kosovës dhe mbikqyrë zbatimin e saj. Bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut, Këshilli përbëhet nga shtatë anëtarë të emëruar nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Këshilli drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës, më 31 dhjetor 2003 përbëhej nga këta anëtarë:

- Z. Ajri Begu, Kryetar i Këshillit Drejtues
- Z. Donat Branger, Drejtor i Përgjithshëm i BPK-së
- Z. David Weatherman, Zëvendës Drejtor për Mbikqyrje të Sektorit Financiar
- Z. Banoit Waelkens, Zëvendës Drejtor për Funksione Financiare
- Z. Nikolaus Graf Lambsdorf, që nga 5 Shtatori 2003
- Z. Gazmend Luboteni
- Z. Petraq Milo, që nga 26 Gushti 2003

Gjatë këtij viti janë larguar dy anëtarë të Këshillit

Z. Chaiha Kim Rhee, më 29 qershor 2003

Z. Andy Bearpark, më 4 Shtator 2003

## RAPORT I REVIZORIT TË PAVARUR PËR KËSHILLIN DREJTUES TË AUTORITETIT BANKAR DHE TE PAGESAVE TË KOSOVËS

Ne REVIDUAM bilancin shoqërues të gjendjes të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK) deri më 31 Dhjetor 2003 dhe pasqyrat përkatëse e të të hyrave, ndryshimet në kapitalin e paguar dhe rezervat si dhe rrjedhën e parave të gatshme në fundin e vitit 2003. Këto pasqyra financiare janë përgjegjësi e menaxhmentit të BPK-së. Përgjegjësia jonë është të paraqesim një mendim mbi pasqyrat financiare bazuar në revidimin tonë.


Ne realizuam revidimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Rrevidim. Këto Standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe realizojmë revidimin në mënyrë që të fitojmë një siguri të arsyeshme, se këto pasqyra financiare nuk bëjnë shtrembërimin material të fakteve. Një auditim përfshirë kontrollin, në baza testuese, dëshminë mbështetëse të shumave dhe heqjeve në pasqyrat financiare. Gjithashtu, një revidim përfshinë vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe vlerësime të rëndësishme të bëra nga menaxhmenti si dhe vlerësimin e përgjithshëm të prezantimit të pasqyrave financiare. Ne besojmë se revidimi ynë paraqet baza të arsyeshme lidhur me mendimin tonë.

Sipas mendimit tonë, duke marrë parasysh të gjitha materialet, pasqyrat financiare prezantojnë në mënyrë të qartë pozitën financiare të Autoritetit Bankar dhe te Pagesave të Kosovës deri më 31 dhjetor 2003 dhe rezultatet e operimeve të saj, ndryshimeve në kapitalin e paguar dhe rezerva dhe rrjedhat e parave të gatshme për fundin e vitit 2003 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përfshirë këtu Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe shpjegimet e nxjerra nga Pleqësia e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Duke mos e marrë parasyshë mendimin tonë, ne ju kujtojmë faktin se aktualisht në Kosovë ekziston pasiguri e cila përfshinë drejtimin e ardhshëm të mundshëm të politikës ekonomike vendore, politikës rregullative dhe zhvillimeve politike. Ne nuk kemi mundësi të parashohim se çfarë ndryshimesh në gjendje mund të ndodhin dhe çfarë efekti mund të kenë këto në pozitën financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës.

<u>Shënime</u>		<u>31 dhjetor 2003</u> (EUR '000)	<u>31 dhjetor 2002</u> (EUR '000)
<b>Mjetet</b>			
Paraja e gatshme në thesar		26,590	17,474
Llogaritë rrjedhëse me bankat joresidente	0	23,784	65,321
Llogaritë e afatizuara me bankat jorezidente	0	404,213	262,696
Prona, ndërtesa dhe paisjet, neto	0	895	621
Mjetet tjera		<u>75</u>	<u>36</u>
<b>Mjetet e tërësishme</b>		<u>455,557</u>	<u>346,148</u>
<b>Obligimet</b>			
Ndaj bankat vendore	0	59,618	46,235
Ndaj institucionet qeveritare vendore	0	351,453	268,869
Ndaj entitetet publike dhe komerciale	0	27,911	19,326
Obligimet tjera vendore	0	<u>2,107</u>	<u>1,782</u>
<b>Obligimet e tërësishme</b>		<u>441,089</u>	<u>336,212</u>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Fondi i obliguar	0	2,556	2,556
Fondi rezervë	0	<u>11,912</u>	<u>7,380</u>
<b>Kapitali dhe rezervat e tërësishme</b>		<u>14,468</u>	<u>9,936</u>
<b>Obligimet, kapitali dhe rezervat e tërësishme</b>		<u>455,557</u>	<u>346,148</u>

Këto pasqyra financiare dhe shënimet përcjellëse, bazuar në llogaritë ligjore të rishtruara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, janë nënshkruar dhe aprovuar më 18 mars 2004 në emër të Këshillit Drejtues të BPK-së nga:




Donat Branger  
Drejtor i përgjithshëm



Benoit Waelkens  
Zëvendës Drejtor i përgjithshëm

Shënime	Fundviti <u>31 dhjetor 2003</u> (EUR '000)	Fundviti <u>31 dhjetor 2002</u> (EUR '000)
Të hyrat nga kamata	8,110	6,765
Shpenzime nga kamata	<u>(2,832)</u>	<u>(3,044)</u>
<b>Të hyra nga kamata (neto)</b>	5,278	3,721
Të hyra nga tarifa dhe provizioni	684	3,041
Shpenzime nga tarifa dhe provizioni	<u>(121)</u>	<u>(184)</u>
<b>Të hyra nga tarifa dhe provizioni (neto)</b>	563	2,857
<b>Të hyrat nga grantet (donacionet)</b>	0	347
<b>Të hyrat tjera nga operimet</b>	0	<u>552</u>
<b>Të hyrat neto</b>	6,740	9,807
<b>Të hyrat tjera jo-operuese</b>		
Shpenzimet e kuadrit	837	929
Amortizimi	512	329
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	0	4,775
Shpenzimet tjera	<u>28</u>	<u>337</u>
<b>Gjithsej shpenzime tjera jo-operuese</b>	<u>2,208</u>	<u>6,370</u>
<b>Fitimi neto për periudhën</b>	<u>4,532</u>	<u>3,437</u>

Këto pasqyra financiare dhe shënimet përcjellëse, bazuar në llogaritë ligjore të rishtruara në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiarë, janë nënshkruar dhe aprovuar më 18 mars 2004 në emër të Këshillit Drejtues të BPK-së nga:



Donat Branger  
Drejtor i përgjithshëm



Benoit Waelkens  
Zëvendës Drejtor i përgjithshëm

Shënime	<u>31 dhjetor 2003</u> (EUR '000)	<u>31 dhjetor 2002</u> (EUR '000)
<b>Rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet operuese</b>		
Fitimi neto për periudhën	4,532	3,437
<b>Zërat jomaterial në pasqyrën e të hyrave</b>		
Amortizimi	512	329
Të hyrat nga grantet	0	(2,860)
<b>Ndryshimi në mjetet operuese</b>		
Rritje në llogaritë depozituese me bankat e huaja (Rritje)/zvogëlim në mjetet tjera vendore	(141,517) (39)	(216,680) 641
<b>Ndryshim në obligimet operuese</b>		
(Zvogëlim)/rritje nga bankat vendore	13,383	(172,958)
Rritje në shuma ndaj institucionet qeveritare	82,584	189,247
Rritje/(zvogëlim) në shuma ndaj subjekteve publike dhe komerciale	8,584	4,841
(Zvogëlim)/rritje në obligimet tjera vendore	<u>205</u>	<u>(21,106)</u>
<b>Rrjedha e parave të gatshme nga aktivitetet operuese</b>	(32,103)	(215,109)
<b>Rrjedha e parave të gatshme nga aktivitetet investuese</b>		
Blerja e mjeteve themelore materiale	<u>(785)</u>	<u>(216)</u>
<b>Paratë e gatshme neto të përdorura në aktivitetet investuese</b>	(785)	(216)
<b>Rrjedha e parave të gatshme nga aktivitetet financiare</b>		
Kapitali i angazhuar	-	-
Fondet e granteve të marrura	<u>467</u>	<u>2,609</u>
<b>Paratë e gatshme neto nga aktivitetet financiare</b>	467	2,609
<b>(Zvogëlim)/rritje në para të gatshme për për periudhën përkatëse</b>	(32,421)	(212,716)
<b>Paraja e gatshme dhe ekuivalente e parave të gatshme në fillim të periudhës përkatëse</b>	<u>82,795</u>	<u>295,511</u>
<b>Paratë e gatshme dhe ekuivalente në fund të periudhës</b>	<u>50,374</u>	<u>82,795</u>

	<u>Kapitali</u> (EUR '000)	<u>Rezervat e përgjithshme</u> (EUR '000)	<u>Fitimi i mbajtur</u> (EUR '000)	<u>GJITHSEJ</u> (EUR '000)
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2001</b>	<u>2,556</u>	<u>3,943</u>	<u>-</u>	<u>6,499</u>
Fitimi neto për vitin përkatës	-	-	3,437	3,437
Transferimi në fondin rezervë	<u>-</u>	<u>3,437</u>	<u>(3,437)</u>	<u>-</u>
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2002</b>	<u>2,556</u>	<u>7,380</u>	<u>-</u>	<u>9,936</u>
Fitimi neto për vitin përkatës	-	-	4,532	4,532
Transferimi në fondin rezervë	<u>-</u>	<u>4,532</u>	<u>(4,532)</u>	<u>-</u>
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2003</b>	<u>2,556</u>	<u>11,912</u>	<u>-</u>	<u>14,468</u>

## **BAZAT E PËRGADITJES DHE FORMA E PREZENTIMIT**

Këto pasqyra financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK-së), janë përgaditur në të gjitha pikëpamjet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) duke përfshirë këtu Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe shpjegimet e nxjerrura nga Pleqësia e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, përveq pagave të financuara nga donatorët, të cilat nuk janë regjistruar si shpenzime në pasqyrat financiare të BPK-së.

### **Valuta e prezentuar**

Deri më 31 dhjetor 2001, pasqyrat financiare të BPK-së, janë të prezantuara në valutën për territorin e Kosovës, marka gjermane (DEM) ishte valutë matëse dhe raportuese për territorin e Kosovës. Në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/4, që nga 1 janari 2002, euro (EUR) është pranuar si një nga valutat zyrtare në Kosovë, dhe për këtë arsye shumat e denominuara në DEM janë shëndrruar në EUR që nga 1 janari 2002 dhe atë duke zbatuar një normë të caktuar dhe të përvokueshme të këmbimit 1 EUR=1.95583 DEM. Nga 1 Janari 2002 librat e BPK-së dhe regjistrat mbahen në EUR.

### **Bazat e kontabilitetit**

BPK-ja mirëmban shënimet e saj të kontabilitetit në përputhje me praktikën e përgjithshme të kontabilitetit të pranuar në territorin e Kosovës të administruar nga Kombet e Bashkuara dhe përgaditë pasqyrat e saja financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgaditur në bazë të parimit të kostos historike.

### **Përdorimi i vlerësimeve**

Për përgaditjen e pasqyrave financiare menaxhmenti duhet të bëjë vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të mjeteve dhe obligimeve dhe zbulimin e mjeteve dhe obligimeve rezervë në datën e pasqyrave financiare dhe shumave të raportuara të shpenzimeve dhe të hyrave gjatë periudhës së raportuar. Rezultatet e tanishme mund të ndryshojnë nga ato vlerësime.

### **Riklasifikimi i shumave krahasuese**

Kur është e domosdoshme, shifrat krahasuese janë përmirësuar sipas nevojës për t'u pajtuar me ndryshimet në prezentimin e vitit vijues.

## PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

### Kamata dhe provizionet

Të hyrave dhe shpenzimet kamatore njihen në baza përlllogaritëse.

Të ardhurat nga provizioni ju kreditohen të ardhurave kur pranohen ndërsa shpenzimi i provizioni debitet në shpenzime atëherë kur paguhet.

### Konvertimi i valutave të huaja

Transaksionet e denominuara në valutë të huaj shndërrohen në EUR me normën zyrtare të këmbimit të BPK-së në datën e transaksionit.

Mjetet dhe obligimet monetare të valutës së huaj shndërrohen në EUR me normën zyrtare të këmbimit të BPK-së në pasqyrat financiare që raportojnë fundin e periudhës.

Normat zyrtare të aplikueshme (EUR për njësi të valutës së huaj) për valutat kryesore më 31 Dhjetor kanë qenë si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2003</u>	<u>31 Dhjetor 2002</u>
Dollari i Shteteve të Bashkuara ("USD")	1.263	0.938
Franku Zviceran ("CHF")	0.642	0.674
Funta Britanike ("GBP")	1.419	1.502

### Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë të gatshme

Për arsye të pasqyrës të rrjedhës së parave të gatshme, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë të gatshme përfshijnë paratë e gatshme në dorë dhe llogaritë rrjedhëse me bankat jorezidente.

### Prona, Ndërtesa dhe paisjet

Prona dhe paisjet janë paraqitur në koston historike duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe provizionin për dëme kur është e domosdoshme.

## PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Në qoftë se vlera e drejtë e një pjese të pronës, qoftë ndërtesë apo paisje është më e ulët sesa shuma e bartur e saj, duke marrë parasyshë rrethanat që nuk mendohet të jenë të përkohshme, ajo pjesë e pronës, ndërtesës apo paisjes shlyhet me anë të vlerës së saj të drejtë.

Fitimet dhe humbjet në shitjen e pronës, ndërtesës dhe paisjeve janë regjistruar në pasqyrën e të hyrave në vitin përkatës.

Amortizimi bëhet në tërë pronën, ndërtesën dhe paisjet bazuar në koston historike. Ngarkesa vjetore për amortizim llogaritet duke shfrytëzuar metodën e drejtë dhe kategoritë e caktuara për secilin mjet të amortizuar në bazë të vlerësimit të kohëzgjatjes së shfrytëzimit. Kohëzgjatja e shfrytëzimit e vlerësuar, e aplikuar gjatë vitit, të përfunuar më 31 Dhjetor 2003 dhe periudhës së përfunduar më 31 Dhjetor 2003 është siç vijon:

	<b>Norma vjetore e amortizimit</b>	<b>Kohëzgjatja e shfrytëzimit</b>
Automjetet	20.0%	5 vjet
Ndërtesa, zyret dhe paisjet tjera	20.0%	5 vjet
Paisjet kompjuterike	33.3%	3 vjet

### Të hyrat nga grantet

Grantet e marrura për qëllim të blerjes së pronës, ndërtesës dhe paisjes, apo prona, paisja dhe ndërtesat e dhuruara janë regjistruar si grante të shtyera në bilancin e gjëndjes dhe janë liruar në të hyrat e granteve brenda periudhës së njëjtë sikurse kohëzgjatja për shfrytëzimin e pronës, ndërtesës dhe paisjes. Grantet e marrura për të financuar shpenzimet e BPK-së kreditohen drejtpërdrejt në të hyrat e granteve në pasqyrën e të hyrave në periudhën që është bërë ai shpenzim.

### Aktivitetet fiduciare

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, në raste të caktuara vepron si një agjent fiskal dhe si agjent pages i Autoritetit Qëndror Fiskal (nga 1 Janari 2003 Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave). Mjetet dhe të hyrat që dalin nga këto aktivitete, janë përjashtuar nga këto pasqyra financiare ku Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës vepron në kapacitet fiduciar si kandidat apo agjenti.

### Vlera e drejtë e mjeteve financiare

Vlera e drejtë është shuma me të cilën mjete financiar mund të shëndrrohet në transaksionin qarkullues ndërmjet palëve të gatshme, ndryshe nga shitja e obliguar apo likuidimi, dhe më së miri regjistrohet me çmimin e caktuar të tregut.

## **PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TE RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**

Autortieti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës mbart mjetet aftashkurta në pasqyrat financiare me çmim të përafërt me vlerën e tyre reale sepse këto mjete kanë afat të shkurtër të qëndrueshmërisë dhe janë të shëndrueshme në para të gatshme dhe kryhen pa kosto të rëndësishme (të madhe) të transaksionit.

### **Tatimimi dhe shpërndarja e fitimit**

Banka lirohet nga tatimi në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/20, mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës të nxjerrur më 15 Nëntor 1999 (dhe e ndryshuar më 1 Tetor 2001), dhe në bazë të ligjit kërkohet që të paguaj çfarëdo mbetje të llogarisë (bilanci) të hyrave të saj neto drejtpërdrejt në Autoritetin Qëndror Fiskal (AQF) pas shpërndarjeve (alokimeve) për të plotësuar nivelet e fondeve reserve të drejtuara nga Këshilli Drejtues.

### **Rezervat e përgjithshme**

BPK-ja në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/20 (siç është plotësuar), për çdo vit duhet të shpërndaj të hyrat neto në llogarinë rezervë të përgjithëshme gjersa llogaritë e kapitalit dhe rezervave të përgjithëshme të arrijnë 5% të shumës së grumbulluar (akumuluar), shuma e bilanceve kreditore e të gjitha llogarive të mbajtura në libra të BPK-së nga mbajtësit e llogarive të paraqitur në bilancin e gjëndjes të BPK-së në fund të secilit vitë financiar.

**LLOGARITË RRJEDHËSE NË BANKAT JOREZIDENTE**

	<u>31 Dhjetor 2003</u> (EUR `000)	<u>31 Dhjetor 2002</u> (EUR `000)
Deutsche Bundesbank	23,573	65,028
Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	22	77
Commerzbank AG	84	150
Svenska Handelsbanken	64	-
Dresdner Bank	<u>41</u>	<u>66</u>
<b>Gjithsej</b>	<u><b>23,784</b></u>	<u><b>65,321</b></u>

Më 31 Dhjetor 2003 llogaritë rrjedhëse të mbajtura me bankat e huaja janë të denominuara në euro dhe sjellin kamatë e cila radhitet ndërmjet 1% në Bundesbankën Gjermane dhe 1.04% në Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG (më 31 Dhjetor 2002: ndërmjet 1.75% dhe 2.01%).

**LLOGARITË E AFATIZUARA NË BANKAT JOREZIDENTE**

	<u>31 Dhjetor 2003</u> (EUR `000)	<u>31 Dhjetor 2002</u> (EUR `000)
Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	51,326	104,378
Commerzbank AG	3,400	48,852
Dresdner Bank	60,087	109,466
Deutsche Bundesbank	70,115	-
ING Bank	62,639	-
KBC	62,865	-
Rabobank	28,033	-
Svenska Handelsbanken	<u>65,748</u>	<u>-</u>
<b>Gjithsej</b>	<u><b>404,213</b></u>	<u><b>262,696</b></u>

## PRONA, NDËRTESA DHE PAJISJET

	Ndërtesa dhe paisjet <u>tjera</u> (EUR '000)	Paisjet <u>e zyres</u> (EUR '000)	Paisjet kompute- rike dhe <u>softveri</u> (EUR '000)	<u>Automjetet</u> (EUR '000)	Gjithsej prona, ndërtesa <u>dhe paisjet</u> (EUR '000)
Bilanci më 1 Janar 2003	435	78	697	72	1,282
Shtesat	153	4	601	27	785
Heqjet	<u>(176)</u>	<u>(37)</u>	<u>(17)</u>	<u>-</u>	<u>(230)</u>
Bilanci më 31 Dhjetor 2003	412	45	1,281	99	1,837
<b>AMORITIZIMI I AKUMULUAR</b>					
Bilanci më 1 Janar 2003	140	20	483	18	661
Ngarkesa për periudhën	81	9	278	16	384
Heqjet	<u>(80)</u>	<u>(10)</u>	<u>(13)</u>	<u>-</u>	<u>(103)</u>
Bilanci më 31 Dhjetor 2003	141	19	748	34	942
<b>VLERA KONTABËL NETO</b>					
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2003</b>	<u>271</u>	<u>26</u>	<u>533</u>	<u>65</u>	<u>895</u>
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2002</b>	<u>295</u>	<u>58</u>	<u>214</u>	<u>54</u>	<u>621</u>

Shtesat në pronë, ndërtesë dhe paisje, deri më 31 dhjetor 2003, përfshijnë 216 mijë euro (31 Dhjetor 2002: 216 mijë) të pronës, ndërtesës dhe paisjeve të blera nga mjetet financiare të granteve të marrura nga Autoriteti Qendror Fiskal, Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Agjencioni Evropian për Rindërtim, Bashkimi Evropian dhe Qeveria Norvegjeze.

## NDAJ BANKAVE VENDORE

	<u>31 Dhjetor 2003</u> (EUR '000)	<u>31 Dhjetor 2002</u> (EUR '000)
Gjithsej llogaritë rrjedhëse	<u>34,686</u>	<u>25,928</u>
Gjithsej	<u>59,618</u>	<u>46,235</u>

Me Rregulloren e mbikqyrjes të BPK-së, rregullën nr. XVII, bankat komerciale të cilat veprojnë në Kosovë duhet të mbajnë rezerva likuiditeti të llogaritur 10% të gjithsej depozitëve të klientëve. Të paktën gjysma e këtyre bilanceve rezervë duhet të mbahen në llogaritë e BPK-së.

Ky bilanc i rezervave mbi 5% deri në 10% të gjithsej depozitëve të klientëve, u paguhet kamatë 0.5% si më 31 Dhjetor 2003 (1.25% më 31 dhjetor 2002). Shumave që janë nën 5% dhe mbi 10% nuk u paguhet kamatë.

**NDAJ INSTITUCIONEVE VENDORE QEVERTARE**

	<b><u>31 Dhjetor 2003</u></b> (EUR '000)	<b><u>31 Dhjetor 2002</u></b> (EUR '000)
<b>Gjithsej</b>	<b><u>351,453</u></b>	<b><u>268,869</u></b>

**NDAJ SUBJEKTEVE PUBLIKE DHE KOMERCIALE**

	<b><u>31 Dhjetor 2003</u></b> (EUR '000)	<b><u>31 Dhejtor 2002</u></b> (EUR '000)
Institucionet financiare jo-bankare	20,554	16,069
Shërbime publike	7,340	2,841
Subjektet jo-komerciale	17	416
<b>Gjithsej</b>	<b><u>27,911</u></b>	<b><u>19,326</u></b>

Norma e kamatës e aplikueshme në llogaritë rrjedhëse më 31 dhjetor 2003 ka qenë 0.5% (me 31 Dhjetor 2002 1.25%)

Më 31 Dhjetor 2003, duke përfshirë shumat nga kompanitë e sigurimeve, është një depozitim në vlerë 5,480 mijë euro me afat të skadimit më 27 Shkurt 2004 dhe 1.6% normë vjetore të kamatës dhe një depozitim në vlerë 1,006 mijë euro me afat të skadimit më 26 Gusht 2004 dhe 1.7% normë të kamatës.

Më 31 Dhjetor 2002, duke e përfshirë shumat nga kompanitë e sigurimeve është një depozitim në vlerë 5,112 mijë euro me afat të skadimit më 27 Shkurt 2003 dhe 2.41% normë vjetore të kamatës dhe një depozitim në vlerë 1,516 mijë euro me afat të skadimit më 22 Gusht 2003 dhe 2.92% normë të kamatës.

## OBLIGIMET TJERA VENDORE

	<u>31 Dhjetor 2003</u> (EUR '000)	<u>31 Dhjetor 2002</u> (EUR '000)
Ndaj Qeverisë (Shënimi a)	795	384
Të hyrat nga grantet e shtyera (Shënim b)	719	599
Ndaj ish-Bankës Popullore të Kosovës (Shënim c)	450	450
Kreditorëve të ndryshëm dhe akrualeve	108	340
Obligimet tjera vendore	<u>35</u>	<u>9</u>
<b>Gjithsej</b>	<u><u>2,107</u></u>	<u><u>1,782</u></u>

**Shënim a:** Më 31 Dhjetor 2003 ndaj Qeverisë janë përfshirë 565 mijë EUR qira të arkëtuara për ndërtesa publike deri në caktimin e pronësisë (31 Dhjetor 2002: 331 mijë EUR) dhe 230 mijë EUR arkëtimi i gjobitjeve të mbikqyrjes (31 Dhjetor 2002: 66 mijë EUR).

**Shënim b:**

	Grante të AQF		Bashkimi		Qeveria	AER	Gjithsej
	AQF	Euro konvertimi	USAID	Evropian	e Norvegjisë		
	(EUR '000)	(EUR '000)	(EUR '000)	(EUR '000)	(EUR '000)	(EUR '000)	(EUR '000)
<b>Të hyrat nga grantet e shtyera</b>							
<b>më 31 Dhjetor 2002</b>	282	94	60	35	15	113	599
Fondet e Granteve të pranuar							
në këtë vit	388	-	79	-	-	-	467
Transferet në të hyrat nga grantet	<u>(136)</u>	<u>(31)</u>	<u>(38)</u>	<u>(18)</u>	<u>(11)</u>	<u>(113)</u>	<u>(347)</u>
<b>Të hyrat nga grantet e shtyera</b>							
<b>më 31 Dhjetor 2003</b>	<u><u>534</u></u>	<u><u>63</u></u>	<u><u>101</u></u>	<u><u>17</u></u>	<u><u>4</u></u>	<u><u>-</u></u>	<u><u>719</u></u>

**Shënimi c:** Shuma e ish Bankës Popullore të Kosovës ka të bëjë me bilancet e parave të gatshme në valuta të ndryshme që i përkasin atij subjekti dhe të cilat fillimisht kanë qenë fizikisht brenda në bankë. Këto bilance janë shëndrruar në DEM, më 22 Dhjetor 2000, ndërsa janë transferuar fizikisht në Commerzbank AG në Frankfurt si dhe janë regjistruar në bilancin e llogarisë rrjedhëse të BPK-së të këtij subjekti.

## FONDI I OBLIGUAR

Në pajtim më Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/20 –Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, kapitali i BPK-së në shumë prej 5 milion DEM (2.556 milion EUR) është ndihmuar nga Autoriteti Qëndror Fiskal, më 31 Mars 2000.

## FONDI REZERVË

Fondi rezervë është themeluar gjatë periudhës deri më 31 Dhjetor 2000, në pajtim më Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/20 dhe vëndimin e Këshillit Drejtues të Bankës. Transferi prej 4.532 mijë EUR është bërë në vitin 2003 (31 Dhjetor 2002: 3, 437 mijë EUR)

## TË HYRA TJERA NGA OPERIMET

	<b>Fundviti</b> <b><u>31 Dhjetor 2003</u></b> (EUR '000)	<b>Fundviti</b> <b><u>31 Dhjetor 2002</u></b> (EUR '000)
Tarifa e liçencimit	342	346
Të hyrat nga qiradhënja	2	16
Shlyerja e obligimeve të pareklamuar	208	-
Tjera	—	7
<b>Gjithsej</b>	<b><u>552</u></b>	<b><u>369</u></b>

## SHPENZIMET E KUADRIT

Shpenzimet e kuadrit përbëhen kryesisht nga pagat e punëtorëve. Më 31 Dhjetor 2003, Banka kishte 124 punëtor (31 Dhjetor 2003: 132 punëtorë).

**SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE**

	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2003 (EUR '000)</b>	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2002 (EUR '000)</b>
Shpenzimet e Sigurisë dhe transportit të parave të gatshme	216	3,258
Shpenzimet për konvertimin (shndërrimin) e Euros	-	369
Riparimet dhe mirëmbajtja	83	176
Shpenzimet e Revidimit dhe Këshillimit	55	157
Shpenzimet e komunikimit (telefoni, teleksi dhe interneti)	102	152
Shërbimet publike	68	122
Udhëtimi dhe transporti	88	199
Shpenzimet e funksionimit të veturave	35	56
Rezervat dhe materjali shpenzues	46	90
Mirëmbajtja e Softver-it	53	49
Shpenzimet për material shpenzues kompjuterik	22	35
Shpenzimet e ushqimit dhe byfësë	35	-
Shpenzimet e sigurimit	22	-
Tjera	<u>6</u>	<u>112</u>
<b>Gjithsej</b>	<b><u>831</u></b>	<b><u>4,775</u></b>

**TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËRLIDHURA**

Pagesa e tërësishme e Këshillit Drejtues e përfshirë në shpenzimet e kuadrit në vitin 2003 ishte 16 mijë euro (11 mijë EUR në vitin 2002).

**RREZIKU I NORMAVE TË KAMATËS**

Tabela në vijim paraqet një përmbledhje të normave efektive të kamatave për mjetet monetare financiare:

	<b>31 Dhjetor 2003</b>	<b>31 Dhjetor 2002</b>
Llogaritë rrjedhëse në bankat jorezidente	1.02%	2.30%
Depozitët e afatizuar në bankat jorezidente	2.04%	2.92%
Ndaj bankave vendore	0.5%	1.25%
Ndaj institucioneve qeveritare	0.5%	1.25%
Ndaj subjekteve publike dhe komerciale	0.5%	1.25%
Ndaj kompanive të sigurimeve	1.62%	2.67%

## MENAXHIMI I RREZIKUT

Gjatë operimeve të zakonshme, BPK-ja i nënshtrohet një numri të rreziqeve, ndër më të rëndësishmet janë rreziku valutor, rreziku operativ, i normës së kamatës, i kredisë dhe i likuiditetit. Struktura e mjeteve dhe obligimeve të BPK-së kryesisht më tepër përcaktohet nga natyra e veprimeve ligjore të BPK-së, sesa nga faktorët komercial. BPK-ja në të njejtën kohë menaxhon ekspozimin ndaj rrezikut përmes teknikave të ndryshme të menaxhimit të rrezikut. Menaxhimi i rrezikut të BPK-së është i rregulluar nga udhëzimet interne të saj, dhe monitorohet nga afër nga Këshilli Drejtues e BPK-së.

Rreziku nga operimet është rrezik që rrjedh për shkak të zvogëlimit të kontrollave të brendshme. BPK-ja e menaxhon këtë rrezik nëpërmjet Departamentit për Revizion të brendshëm të BPK-së, që ushtron kontroll në politikat dhe procedurat e kontabilitetit dhe funksionimin efikas të sistemit të kontrollave të brendshme të BPK-së.

### Rreziku i normave të kamatës

BPK-ja i nënshtrohet rrezikut të çmimit të normave të kamatës në tregjet vendore dhe të jashtme, kryesisht si rezultat i investimit të rezervave të jashtme këmbyses në norma të caktuara të kamatës, në shuma dhe për periudha që ndryshojnë nga depozitët e afatizuar dhe fondet tjera të huazuara.

### Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit shpjegohet si rrezik nga humbjet që rrjedhin nga mospërputhja e skadimeve të afateve (maturimeve) të mjeteve dhe obligimeve. Skadimet e afateve të mjeteve dhe obligimeve dhe mundësia për të zëvendësuar, me çmim të arsyeshëm, obligimet që bartin kamatë në afatin e tyre të skadimit, janë faktorë të rëndësishëm në caktimin e likuiditetit të BPK-së dhe ekspozimin e BPK-së ndaj ndryshimeve në normat e kamatës dhe këmbimit.

### Rreziku i kreditimit

BPK-ja i ekspozohet rrezikut të kreditimit që është një rrezik kur pala e kundërt (klienti) nuk ka mundësi të paguaj shumën e tërësishme brenda afatit. Maksimumi i ekspozimit të rrezikut të kredisë në BPK, duke mos përfshirë vlerën e hipotekës, kryesisht paraqitet në vlerën mbajtëse të mjeteve financiare. Ndikimi i mundshëm i netimit të mjeteve dhe obligimeve për zvogëlimin e ekspozimit të potencialit kreditor nuk është i rëndësishëm.

*Menaxhimi i rrezikut të kredisë.* Rreziku i kreditimit në transaksione me rezervat e valutës menaxhohet përmes aprovimit të transaksioneve dhe plasimeve të fondeve, vendosjes së kufijve që zvogëlojnë rrezikun dhe vëzhgim të vazhdueshëm të pozicioneve. Kufizimet e palës së kundërt vendosen në bazë të radhitjeve kreditore dhe kontrollohen vazhdimisht.

## MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

### Rreziku i valutës

Rreziku i valutës është rrezik të cilin vlera e mjeteve financiare oscilon (lëkundet) për shkak të ndryshimeve në normat e këmbimeve të valutave të jashtme.

Tabela në vijim analizon mjetet dhe obligimet e BPK-së në grupime përkatëse të afateve të skadimit bazuar në periudhën e mbetur të dates së bilancit të gjendjes në datë të kontraktuar të skadimit të afatit, më 31 Dhjetor 2003:

	<u>Deri në</u> <u>1 muaj</u> (EUR '000)	<u>1 deri në 3</u> <u>muaj</u> (EUR '000)	<u>3 muaj deri</u> <u>në 1 vit</u> (EUR '000)	<u>1 deri në 5</u> <u>vjet</u> (EUR '000)	<u>Totali</u> (EUR '000)
<b>Mjetet</b>					
Para të gatshme	26,590	-	-	-	26,590
Llogaria rrjedhëse në bankat jorezidente	23,784	-	-	-	23,784
Llogaritë e afatizuara në bankat jorezidente	357,074	46,131	1,008	-	404,213
Prona dhe paisjet	-	-	-	895	895
Mjetet tjera	<u>75</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>75</u>
<b>Mjetet e tërësishme</b>	<u>407,523</u>	<u>46,131</u>	<u>1,008</u>	<u>895</u>	<u>455,557</u>
<b>Obligimet</b>					
Ndaj bankave vendore	59,618	-	-	-	59,618
Ndaj institucioneve qeveritare	351,453	-	-	-	351,453
Ndaj subjekteve publike dhe subjekteve komerciale	19,224	5,480	1,006	2,201	27,911
Obligimet tjera	<u>2,107</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>2,107</u>
<b>Obligimet e tërësishme</b>	<u>432,402</u>	<u>5,480</u>	<u>1,006</u>	<u>2,201</u>	<u>441,089</u>
<b>Neto gepi i likuiditet</b>	<u>(24,879)</u>	<u>40,651</u>	<u>2</u>	<u>(1,306)</u>	<u>14,468</u>

## ZOTIMET DHE REZERVAT

### Ankesa të përgjithëshme

Vazhdimisht gjatë rrjedhës normalë të punës, janë pranuar ankesa kundër BPK-së nga partnerët e saj. Menaxhmenti kundërshtoj ankesat e tilla dhe mendon se nuk do të ketë asnjë humbje materiale.

### Veprimet ligjore

Më 31 Dhjetor 2003, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës nuk ka qenë i përfshirë në asnjë veprim gjyqësorë material.

### Zotimet lidhur me kreditë

Më 31 Dhjetor 2003, BPK ka patur angazhime të plasoj depozita më ING, KBC, Deutsche Bundesbank dhe Svenska Hamlesbanken në një shumë prej 49,598 mijë EUR.

## NGJARJET QË PASOJNË

Duke filluar nga 1 Janari 2004, norma e kamatës për llogaritë rrjedhëse të klientëve është 1%.

V. APPENDICES

Glossary of terms

<b>BPK</b>	Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës
<b>UME</b>	<b>Unioni Monetar Evropian</b>
<b>QPP</b>	Qendra për Përsosmëri në Financa
<b>ShDK</b>	Shërbimi Doganor i Kosovës
<b>GZD</b>	Grantet e Zotuara të donatorëve
<b>AER</b>	Agjencioni Evropian për Rindërtim
<b>BQE</b>	Banka Qendrore Evropiane
<b>BE</b>	<b>Bashkësia Evropiane</b>
<b>IHD</b>	Investimet e Huaja Direkte
<b>IRJM</b>	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
<b>IÇK</b>	<b>Indeksi i Çmimeve të Konsumit</b>
<b>BPV</b>	Bruto Produkti Vendor
<b>BPN</b>	Bruto Produkti Nacional
<b>IHÇK</b>	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit
<b>TVSH</b>	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
<b>SNK</b>	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
<b>SPN</b>	Sistemi i Pagesave Ndërbankare
<b>NjPK</b>	Njësia e Përkohshme Kreditore
<b>FMN</b>	Fondi Monetar Ndërkombëtar
<b>IPV</b>	Instituti i Përbashkët në Vienë
